

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7752 E shtunë 29 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"  
Viti 2018 për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë, Bosnje-Hercegovinën mund të quhet çdo gjë tjetër, por jo vit suksesi. Vërtet që Shqipëria ...  
Vijon në faqen 20

Nga THOMAS BREY  
Shqipëria dhe nami si Kolumbia e Europës  


Opinion i Ditës  
Pas muajsh ndërtimi të themeleve dhe përgatitjes së terrenit, gjatë javëve të fundit ka pasur disa arritje të rëndësishme në procesin e vetingut të gjyqësorit ...  
Vijon në faqen 21

Nga GENOVEVA RUIZ CALAVERA  
Koha për ndryshim në gjyqësorin shqiptar  




Basha: Qeveria, korrupsion e paaftësi  
**Paralajmërohen Klosi e Manastirliu, Rama: Ndryshimet, për mandatin e tretë**

Meta: Me rëndësi, ndryshimi i filozofisë së qeverisjes. Kryemadhi: Ra qeveria e Surrelit  
Kryeministri Rama prezantoi dje në Asamblenë e PS-së ndryshimet në kabinetin qeveritar. Pavarësisht se këto lëvizje i arsyetoi me synimin për të marrë mandatin e tretë dhe i quajti refektim, të gjithë sektorët përkatës, ai i quajti si histori suksesi. Në fund bëri një paralajmërim për ministrin e Shëndetësisë, Manastirliu ...  
Në faqet 4-5

## LEVIZJET/ KUSH JANE 2 TE RINJTE NGA KOSOVA QE MARRIN ARSIMIN DHE MPJ **RAMA LARGON 7 MINISTRA, JA SI NDRYSHON QEVERIA**

Erjon Braçe zëvendëskryeministër. Ikin Arben Ahmetaj dhe Lindita Nikolla, Belinda Balluku zëvendëson Gjicknurin. Ngjitet Spiropali, rikthehet Bledi Çuçi



(Në foto) Ministrat e rinj të kabinetit "Rama" Në faqet 2-3

**PERPLASJA**  
Vrasja në Laprakë, zbulohet sherri mes të rinjve 10 ditë para krimit  
Në faqen 9

**KULTURE**  
Kolec Topalli, nga telat me gjemba te fjalori i ri etimologjik  
Në faqen 12

**PROPOZIMI**  
Emigrantët në protestë: Të krijohet partia e nacionalistëve  
Në faqen 7

**SPORT**  
Trajneri i Juves, Alegri tundohet nga mundësia e kalimit te Junajtidi në Angli  
Në faqen 22

**"BLUETOOTH"**  
  
Urimet e VIP-ave të 'showbiz'-it dhe kandidatët për çift në vitin 2019  
Suplement  
Në faqet 8

Krimi në Bulqizë/ 40-vjeçari qëllohet me thikë pasi plagosi dy familjarë të gruas  
**I pret veshët kunatit, vritet dhëndri**  
Flet vjehrra e Adriatik Jellës: Na tha "do ju përdhunoj femrat"

Një ngjarje në përmasat e makabres ka ndodhur në Bulqizë. Dhëndri është vrarë nga njerëzit e nuses në banesën e tyre, ndërkohë që të plagosur kanë mbetur edhe dy persona të tjerë. "BalkanWeb" mëson se gjithçka nisi një ditë më ...  
Në faqen 8



# QEVERIA EMRAT

Qeveria e re, nga kosovarët deri te bankierja Denaj e arkitektja Margariti

## Kabineti i ri qeveritar, me Braçen, Spiropalin e Shalsin

Kush janë ministrat e rinj të "Rama 3"

Emra jo shumë të njohur për publikun, por me kontribut të nivelit teknik në qeverisjen e majtë. Këta janë emrat e përzgjedhur nga kryeministri Edi Rama për të vijuar të bashkëqeverisë me ta deri në përfundim të këtij mandati qeverisës. Plot 5 nga 9 emrat e rinj që janë bërë pjesë e kabinetit qeveritar nuk janë fare politikë, ndërsa kanë mbajtur vetëm pozicione të nivelit të dytë apo të tretë në administratë. Vetëm 4 prej tyre vijnë nga radhët e Partisë Socialiste, ndërsa mbajnë edhe mandatin e deputetit. Erion Braçe është propozuar për të qenë zëvendëskryeministri i ri dhe për t'u bërë kështu për herë të parë pjesë e një kabinetit qeveritar. Ai është një nga deputetët më të vjetër dhe njëherë për karakterin e tij "rebel" dhe që nuk ka nguruar të kritikojë edhe qeverinë. Një emër tjetër i njohur për publikun është edhe ai i Bledi Çuçit, që do mbajë postin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Çuçi është zgjedhur deputet në Gjirokastrë dhe më parë gjatë mandatit të shkuar qeverisë ka mbajtur postin e ministrit për Marrëdhëniet me Pushtetin Vendor. Në qeveri rikthehet edhe Eduard Shalsi, i cili gjatë qeverisë teknike të vitit 2017 mbajti postin e ministrit për Çështjet Vendore, duke zëvendësuar atëherë pikërisht Bledi Çuçin. Edhe Shalsi ka qenë një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Ramës që gjatë kohës që ai drejtoi Bashkinë e Tiranës. Aktualisht Shalsi mban pozicionin e kryetarit të Komisionit të Vepërimitarisë Prodhuese. Një tjetër emër nga radhët e politikës është edhe ai i deputetes Elisa Spiropali në pozicionin e ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Spiropali është një emër i njohur për publikun, pasi më parë ka milituar në radhët e "MJAFIT" dhe më pas ka bërë jetë partie në PS. Ajo gjatë mandatit të parë qeverisës mbajti edhe postin e drejtorit të Doganave, ku qëndroi për gati dy vite. Të gjithë emrat e tjerë janë thuar krejtësisht teknikë dhe i njëjti profil të ulët publik. Kështu, Besa Shahini do të drejtojë Ministrinë e Arsimit. Ajo vjen nga Kosova dhe ka qenë zëvendësiministre e Arsimit prej vitit 2017. Besa Shahini është analiste dhe hulumtuese e çështjeve të integritimit evropian dhe politikave arsimore. Deri në verë të 2015-ës ka punuar si analiste me organizatën me bazë në Berlin, Iniciativa Europiane për Stabilitet (ESI). Shahini ka master nga "Heriot School of Governance" në Berlin. Anila Denaj, drejtuesja më e re e një prej ministrive më të rëndësishme, siç është ajo e Financave në vend. Ajo



### NDRYSHIMET NË QEVERI, PËRLOTET MIRELA KUMBARO

Mirela Kumbaro është një nga ministrat e propozuara nga Rama për të lënë postin e ministres së Kulturës. Por, duket se ajo nuk i ka mbajtur dot emocionet dhe taksa Rama ka deklaruar se do të largonte gjithë ministrat që kishin 5 vite në kabinet. Kumbaro është parë të përlozet. Kjo në fakt nuk është hera e parë që e shohim atë të përlozet, pasi më parë gjatë debati me kryeministrin, ajo ka qarë edhe në sallën e Kuvendit.



**ERION BRAÇE**  
Erion Braçe është propozuar për të qenë zëvendëskryeministri i ri dhe për t'u bërë kështu për herë të parë pjesë e një kabinetit qeveritar. Ai është një nga deputetët më të vjetër dhe njihet për karakterin e tij "rebel".



**ELISA SPIROPALI**  
Spiropali është një emër i njohur për publikun, pasi më parë ka milituar në radhët e "MJAFIT" dhe më pas ka bërë jetë partie në PS. Ajo gjatë mandatit të parë qeverisës mbajti edhe postin e drejtores së Doganave.



Qeveria e re, Rama: Hap i madh drejt fitores së qershorit

Kryeministri Edi Rama u është përgjigjur kritikëve për ndryshimet e reja në qeveri. Përmes një postimi në "Facebook", Rama thotë se salinjtë e kadrinjtë që gjuajnë qeverinë e re nuk e fshihin dot gishtin e mbetur në gojë. Sipas kryeministrin, me ndryshimet në kabinetin qeveritar, është hedhur një hap i madh drejt fitores në zgjedhjet lokale të qershorit. "Oh sa e bukur radha e salinjve e kadrinjve që gjuajnë qeverinë e re, pa e fshetur dot gishtin e mbetur në gojë (edhe njëherë si përherë). Skanë faj jo, sepse kemi hedhur një hap të madh sot drejt fitores së qershorit tjetër. Qentë lehin më fort kur karvani ecën më shpejt. Krenar për PS", shkruan Rama në "Twitter".

## Qeveria "Rama 3", Kuvendi mund të mblidhet në fillim të janarit

Pas deklarimit të ndryshimeve në kabinet, Rama pritet që të dërgojë në Presidencë propozimet për emrat e shkarkuar dhe emrat e rinj që do bëhen pjesë e qeverisë. Por, nisur nga përvoja me rastin e emërimit të ministrit të ri të Brendshëm rreth një muaj më parë, kryeministri duket se ndodhet sërish para një konflikti me presidentin Ilir Meta. Jo vetëm se ka emëruar në qeveri dy shtetas nga shqiptarët e Kosovës, por edhe për shkak se vetë presidenti dje shpreh rezervat e tij për ndryshimet e bëra. Gjithsesi, edhe në rastin më të



mirë nëse Rama do i dërgojë gjatë kësaj jave emrat në Presidencë për dekretim dhe presidenti do të respektojë afatin kushtetues për të hedhur firmën e tij, do duhet që Kuvendi i Shqipërisë të mblidhet në fillim të janarit për të bërë votimin e ndryshimeve në qeveri. Kjo,

pasi Kushtetuta i jep presidentit 7 ditë kohë për t'u shprehur, ndërsa më pas Kuvendi ka 10 ditë kohë për t'i votuar. Në këtë mënyrë i bie që Kuvendit duhet të mblidhet në një seancë të jashtëzakonshme diku nga fillimi i janarit për t'i miratuar këto ndryshime.

Në vitin 2013 deri në vitin 2015 ka mbajtur pozicionin drejtues në Ministrinë e Financave. Një tjetër emër thuarje i panjohur është edhe ai Genti Cakajt. Ai ka qenë këshilltari për politikë të jashtme i kryeministrit Edi Rama dhe më pas është emëruar në qershor 2018 si zëvendësiministre për Europën dhe Punë e Jashtme. Filozofi i ri nga Kosova ka drejtuar dhe ekipin nego-

ciator të Shqipërisë për çeljen e negociatave me BE-në. Opozita pretendon se ai është një emër i sugjeruar nga gazetari dhe analisti Baton Haxhiu. Rama emëroi edhe Belinda Ballukun në pozicionin e ministrit të Infrastrukturas. Ajo prej kohës ka drejtuar "Albcontrol" dhe në një batutë gjatë ceremonisë së "Air Albania", kryeministri e ka cilësuar si

"shtriga kuqezi" e aviacionit. Balluku më herët ka punuar me kryeministrin Edi Rama si drejtoreshë e Kabinetit në Bashkinë e Tiranës. Ndërkohë një tjetër emër i ri në kabinet është edhe Elva Margariti, që do të mbajë pozicionin e ministres së Kulturës. Ajo aktualisht është këshilltare në Kryeministri dhe koordinatore e projektit të "100 Fshat-



Pas protestave, kryeministri zyrtarizoi dje ndryshimin e qeverisë

# Rama ndryshon gjysmën e qeverisë, kush ikën e kush vjen

Surprizë largimi i Ahmetajt, Bushatit dhe Peleshit

Për herë parë në 5 vite qeverisë, kryeministri Edi Rama bëri dje një riformatim të thellë të kabinetin qeveritar, duke larguar thuajse të gjitha figurat politike dhe duke e kthyer qeverinë e tij në një kabinet tërësisht teknik. Ashtu siç edhe ishte paralajmëruar, kreu i qeverisë ka bërë dje ndryshimet në qeverinë e tij, duke larguar 8 ministra dhe duke emëruar 9 të tjerë, pra duke shtuar kështu edhe një ministri tjetër pa portofol dhe që do merret me marrëdhëniet me parlamentin. Ndonëse për vetë ministrat e larguar bëra publike e këtyre ndryshimeve nuk kishte më asnjë surprizë, pasi Rama ua kishte bërë të ditur me parë, për të gjithë anëtarët e Asamblesë dhe opinionionin publik, ky riformatim për nga përmasat dhe emrat që përfshiu në pjesën më të madhe ishte vërtetë një surprizë. Kështu, Rama hoqi gjithë ministrat që kishin mbi 5 vite në kabinet dhe që konsideroheshin si emra shumë të fuqishëm brenda mazhorancës dhe qeverisë. Përfshitëm në vetëm largimi i zëvendëskryeminstres Senida Mesi, e cila kishte vetëm pak më shumë se 1 vit në detyrë. Por surprizë përbëjnë jo vetëm emrat e larguar, por edhe emrat e rinj që u bënë pjesë e qeverisë. Me përjashtim të Blendi Klosit si ministër i Turizmit dhe Mjedisit dhe Pandeli Majkos si ministër i Diasporës, e gjithë pjesa tjetër e kabinetit qeveritar të Edi Ramës mund të konsiderohet e një niveli teknik, me njerëz që para se të zgjidheshin ministra ose nuk njiheshin fare, ose kanë mbajtur pozicione shumë inferiore. Duhet thënë se të gjithë ministrat kryesor që u larguan janë zëvendësuar nga vartësit e vetë.



Mbledhja e djeshme e Asamblesë Kombëtare të PS-së

një strategji elektorale për zgjedhjet e ardhshme vendore, pasi pritet të rikthehet të rikandidojë në Korçë. Ai do zëvendësohet nga Bledi Çuçi, i cili rikthehet në qeveri pas një eksperience të shkurtër që pati në mandatin e shkuar.

### LËVIZJET E PARASHIKUARA

Ndërkohë që të gjitha lëvizjet e tjera në kabinet mund të konsiderohen të paralajmëruara. Kështu, Rama largoi Damian Gjikonurin nga pozicioni i ministrit të Infrastrukturës për ta zëvendësuar edhe atë me një vartësin e vet, drejtoreshën e "Albcontrol", Belinda Balluku. Largimi i Gjikonurit ishte bërë thuajse fakt i kryer pas skandalit me kompaninë "DH Albania", të cilës institucionet në varësi të tij i kishin dhënë vetëm në muajt e fundit 30 milionë euro tendera. Ndërkohë që nga ana tjetër Balluku është një njoheje e vjetër e Ramës, pasi ka qenë asistente e tij që në kohën që ishte në opozitë. Një tjetër largim i pritshëm ishte edhe ai i Lindita Nikollës, e cila edhe vetë e kishte larguar disa herë largimin pas protestave të studentëve. Rama e evitoi atë thuajse në të gjitha daljet publike dhe takimet që kreu me studentët javën e shkuar. Edhe Nikolla zëvendësohet në këtë pozicion nga zëvendësministrja e saj, Besa Shahini. Edhe Shahini, ashtu si edhe Caka vjen nga Kosova. Një tjetër largim nga kabineti është edhe ai i Mirela Kubaros nga posti i ministres së Kulturës. Kubaros zëvendësohet në këtë pozicion nga Elva Margariti, drejtoresha e projektit të "100 Fshatrave". Rama ka larguar edhe Sonila Qaton nga posti i ministres së Shtetit për Sipërmarrjen. Surprizë nga PS bëjnë me dije se edhe largimi i saj ka të bëjë me shumë me lëvizjen për në një pozicion tjetër të rëndësishëm. Ajo do të zëvendësohet në këtë pozicion nga Eduard Shal-si, i cili gjithashtu rikthehet në qeveri. Kryeministri Rama ka shtuar kabinetin e tij qeveritar edhe me një post të ri, atë të ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Ky pozicion iu besua Elisa Spiropalit.

### DUARTROKITET BRAÇE

Në momentin që kryeministri Edi Rama ka deklaruar emërimin e Braçes në postin e zëvendëskryeminstres, anëtarët e Asamblesë Kombëtare kanë shpërthyer në duartrokitje në shenjë konfirmimi për zgjedhjen e bërë. Braçe është e hera e parë që përfshihet në kabinet qeveritar dhe një nga detyrat që i janë ngarkuar është edhe ndjekja e reformës së thjeshtimit të shërbimeve në sportet shtetërore.

### QEVERIA "RAMA 3"

- Kryeministër Edi Rama
- Zëvendëskryeministër, Erion Braçe
- Ministër e Mbrojtjes, Olta Xhaçka
- Ministër i Rendit, Sandër Lleshaj
- Ministër e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj
- Ministër e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku
- Ministër e Drejtësisë, Etilda Gjonaj
- Ministër i Europës dhe Punët e Jashtë, Genti Caka
- Ministër e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu
- Ministër e Arsimit dhe Rinisë, Besa Shahi
- Ministër i Bujqësisë, Bledi Çuçi
- Ministër i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi
- Ministër e Kulturës, Elva Margaritari
- Ministër i Diasporës, Pandeli Majko
- Ministër i Sipërmarrjes, Eduard Shal-si
- Ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali

### NDRYSHIMET

1. Erion Braçe zv. kryeministër i ri, në vend të Senida Mesit
2. Anila Denaj në vend të Arben Ahmetajt
3. Genti Caka në vend të Ditmir Bushatit
4. Bledi Çuçi në vend të Niko Peleshit
5. Elva Margariti në vend të Mirela Kubaros
6. Eduard Shal-si në vend të Sonila Qatos
7. Belinda Balluku në vend të Damian Gjikonurit
8. Besa Shahini në vend të Lindita Nikollës
9. Elisa Spiropali, ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

### DEKLARATAT

#### STUDENTËT

Një timon i prishur dhe Kushtetuta e Shqipërisë ishin simbolet që zgjodhën dje studentët për të protestuar. Në lidhje me ndryshimet në qeveri, ata thanë se nuk kanë asnjë ndikim tek protesta që do të rinisë në janar.



#### IRONIA

Përmes një postimi në "Instagram", Rama publikon një meme që flet për shkarkimin e kreut të opozitës. Krahas saj, kryeministri shkruan "largqoftë", ndërsa e shoqëron me emoji.



#### JEHONA

Agjencia e lajmeve italiane "ANSA" shkruan se largimi i tyre erdhi si pasojë e protestave të studentëve, pavarësisht se kërkesat e tyre ishin më shumë të natyrës ekonomike.



itive shtetërore. Bëhet fjalë për Erion Braçen, i cili do të mbajë pozicionin e zëvendës kryeministrit. Ndërkohë që largimi i Senida Mesit duket se ka të bëjë me shumë me një taktikë të socialistëve për ta ruajtur si figurë se sa ka të bëjë me performancën e saj në pozicionin që mbante. Kjo pasi në PS, ajo shihet si kandidata e socialistëve për Bashkinë e Shkodrës.

#### SURPRIZAT

Një tjetër emër që u largua nga qeveria dhe që përbën një surprizë është ai i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Ai kishte 5 vite në pozicione të ndryshme të qeverisë dhe konsiderohej si një emër më të fuqishëm në qeverinë "Rama". Ahmetaj u zëvendësua nga një prej vartësve të tij. Bëhet fjalë për Anila Denajn, që drejton Fondin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor. Një tjetër surprizë dhe lëvizje e paparashikuar nga kabineti qeveritar është edhe largimi i Ditmir Bushatit nga posti i ministrit të Europës dhe Punëve me Jashtë. Jo vetëm sepse konsiderohej si një nga ministrat që kishte punuar mirë, por edhe për vetë faktin se ka negociuar një nga marrëveshjet më të rëndësishme, atë me Greqinë. Surprizë nuk bën vetëm largimi i Bushatit, por edhe emri që do të zëvendësojë atë. Bushati do të zëvendësohet nga një prej këshilltarëve të tij, Genti Caka, i cili vetëm pak muaj më parë ka marrë shtetësinë shqiptare, pasi është shqiptar nga Kosova. Një ndryshim i papritur në qeveri konsiderohet edhe ai Niko Peleshit nga posti i ministrit të Bujqësisë. Largimi i tij lidhet edhe me

# ASAMBLEJA E PS FJALIMI I RAMES

Fjala e plotë në Asamblenë e PS/ Kryeministri argumenton ndryshimet

## Edi Rama u lë afat Klosit dhe Manastirliut: Keni 6 muaj kohë

“Eksperienca po na pengon, po bëhet alibi”

Kryeministri Rama prezantoi dje në Asamblenë e PS-së ndryshimet në kabinetin qeveritar. Pavarësisht se këto lëvizje i arsyetoi me synimin për të marrë mandatin e tretë dhe i quajti reflektim, të gjithë sektorët përkatës, ai i quajti si histori suksesi. Në fund bëri një paralajmërim për ministrin e Shëndetësisë, Manastirliu dhe atë të Mirëqenies Sociale, Klosi.

### FJALIMI I KRYETARIT TE PS

“Uroj që të gjithë ju, së bashku me të gjithë anëtarët e familjes sonë të madhe politike të keni një Vit të Ri të gëzuar, me shëndet dhe mbarësi në familjet tuaja!”

Ky në fakt është një takim i pazakontë, në një kohë të pazakontë të vitit për mbledhje partie, në një moment të pazakontë për këtë familje, e cila ka përgjegjësinë të kujdeset për shtëpinë e madhe të shqiptarëve, Shqipërinë. Por, e pazakontë është edhe mundësia që na ka dhënë në këtë fundviti, protesta e studentëve. Një mundësi e mirëseardhur në formën e një reagimi shumë kuptimplotë në emër të një jete të mirë universitare, por njëkohësisht, edhe në emër të besimit të ne dhe tek unë si i pari i kësaj familjeje. Përtej halleve nëpër plot familje, vështirësive të llojllojshme në mjediset mësimore, kushteve shpesh të rëndësishme të konviktit, indiferencës dhe mosbesimit ndaj politikës, pjesa dërrmuese e atyre vajzave dhe djemve, edhe kur çirreshin mu përpara fytyrës time, “turp, turp, turp” në oborin e Universitetit “Ismail Qemali”, shihnin dhe shohin në drejtimin tonë, sepse jemi për ta mundësia e vetme për zgjidhjen e kërkesave të tyre.

Ata na dhanë një shuplakë, e cila mua më përvëlonte njësoj si ditën e parë dhe unë zgjodha t’u kthej atyre faqen tjetër, jo pse kanë të drejtë në të gjitha ato që kërkojnë, aq më pak kanë të drejtë në mënyrën si i kërkuan, ndonjëherë dhe jashtë çdo norme elementare të mirësjelljes së mësuar në familjen më të zakonshme shqiptare. Iu kam kthyer faqen tjetër, sepse, në thelb, përtej formave të shfaqjes, ata kanë të gjithë të drejtën të jenë të acaruar me ne, përdërisa nga ne dhe askuar tjetër presin shumë më tepër. Ndërsa nga të tjerët, jo s’presin asgjë, por i kanë sikterisur larg vetes, madje duke i përcmuar publikisht. Kam folur disa herë në këtë Asamble. Fjalët e mia kanë rënë në vesh të shurdhër. Qeveria nuk janë ministrit. Qeveria e Partisë Socialiste janë të gjithë ata që na përfaqësojnë në territor. Ky është momenti i parë i kthesës së madhe që ne do të bëjmë.



Ministri Blendi Klosi



Ministria Ogerta Manastirliu

Të gjithë së bashku, ose me të gjithë ata që janë dakord me këtë. Kush nuk është dakord me këtë, le të shkojë të bëjë një parti tjetër. Për këtë ia vlen të lihet edhe pushteti, nëse, që unë nuk e besoj kurrë, - pushteti na genka derivat i atyre metodave skandalozë të tepsisë që kanë infektuar edhe PS-në. Ajo sëmundje nuk ka lidhje me ne, nuk ka lidhje me atë që themi e me atë që jemi. Ajo sëmundje është armiku që ne do të luftojmë bashkërisht. Do të shpallen të gjitha vendet e punës në Shërbimin Civil dhe pa asnjë konkurs e procedurë. Kush ka 9-ta dhe 10-ta, sipas radhës, do të zgjedhë vendin në ministri, agjenci, hipotekë, ALUËZIN, kutë dojë, voton për ne, apo s’voton për ne, është djali i kryetarit të PS-së, apo është djali i kryetarit të PD-së, del në fushatë, apo s’del në fushatë për të t’i dojë kokrra e qejfit. Ne na duhet dija e tij apo e saj, nuk na duhet fare se për kë voton. Dhe të mos e diskutojmë më këtë gjë! Ne do të bëjmë Kongresin në mars dhe çdo anëtar i kësaj Asambleje do të duhet të tregojë në bazë të detyrave, atë që ka bërë, përndryshe nuk do të jetë më në Asamble. Çdo anëtar i kryesisë të partisë do të duhet të tregojë detyrat që ka bërë përndryshe nuk do të jetë më në kryesinë e partisë. Është një Kongres i radhës, por është një Kongres që do të lirojë nga detyra të gjithë anëtarët e Asamblesë, që deri në Kongres nuk do të adresojnë në atë pjesë që ju takon në vijën e frontit, atë që vendosen këtu. Ne nuk mund të perceptohemi si kastë dhe eksperienca jonë nuk mund të jetë alibi. Kur bëjmë qeverinë e parë, shumëkush thoshte “janë pa eksperiencë”. Kur më pyesnin mua kush është cilësia më e mirë e ministrave të kabinetit tënd, u thosha se është

mungesa e eksperiencës. Sepse mungesa e eksperiencës është një vlerë e jashtëzakonshme në momentin kur duhet të bësh gjëra, të cilat nuk janë bërë me vite dhe gjëra për të cilat ekspertët thonë jo nuk bëhet kjo, se e kemi provuar këtë dhe nuk bëhet.

Sot, eksperienca po na pengon, sepse ka filluar të bëhet alibi. “Ta shohim, ja ku jemi”, - nga deputetët e kam dëgjuar. Sa është rritur volumi i fjalës “ta shohim” kur flisja me ministrat! Kur filloi protesta e studentëve në rrugë, mora Elion. I thashë, Elio, çfarë bën, ku i ke ata të FRESH-it? Aty tha, tek ministria.

### NEPOTIZMI

“Partia Socialiste nuk mund të kthehet në opozitë për shkak të krushqve, tezeve, motrave, xhaxhallarëve, grave, kunatave e të gjitha me radhë. Harrojeni! Ose bëni një gjest të thjeshtë, ikni nga Partia Socialiste”, deklaroi kreu i qeverisë.

Shumë mirë, edhe FRESH-i në protestë tek ministria, fëmijët tanë. Domethënia, shumë e madhe, por nga ana tjetër ka ardhur koha që të nxjerrim një mësim nga eksperienca dhe nga çfarë dëgjuar nga studentët gjatë gjithë ditëve. Edhe ata që ishin të doktorëshës dhe të artistit thoshin “nuk i duam forumet këtu”, se iu vjen turp të thonë jemi të forumeve. FRESH-i nuk mund të jetë më organizata ekskluzive e rinisë socialiste. FRESH-i mund të jetë një nga organizatat. Ne do t’u japim mundësi të rinjve të organizohen si të duan. Ne do t’i japim mundësi edhe atyre studentëve që nuk duan të merren me parti, nuk duan të merren me politikë për qëllimet e tyre të organizohen dhe të regjistrohen si një grup interesi pranë nesh. Forumin e gruas e dëgjoj vetëm kur ka zgjedhje dhe zihen gratë me njëra-

tjetër. Nuk e shoh as ku është dhe as çfarë bën. Nuk ka nevojë të ketë forum gruaja, le të organizohen të gjithë si të duan. Pse duhet të kemi forumin e grave komuniste, për çfarë arsye? Vetëm zihen me njëra-tjetër kur ka zgjedhje dhe bashkohen për 8 Mars, sepse bëjnë sikur shkojnë shumë mirë me njëra-tjetër dhe këtu mbaron. Për çfarë na duhet ne forumi i grave komuniste, vetëm për sherr! Ndërkohë që gratë i kemi integruar në Partinë Socialiste, i kemi integruar në qeveri. Ndërkohë që edhe qeveria e re sot do të ketë 50% gra.

Pra, për çfarë na duhen? Do të ishte absolutisht e pavërtetë, nëse do të thuej që sot, ndryshimi vjen si rezultat i dështimeve. Jo! Ndryshimi vjen si rezultat i nevojës për të adresuar ato që thashë dhe të tjera akoma dhe i domosdoshmërisë për të zgjeruar kapacitetin tonë në qendër dhe në terren, kapacitetin tonë qeverisës dhe kapacitetin tonë komunikues në çdo komunitet. Ata janë një pjesë e mirë e udhëheqës të Partisë Socialiste. Janë një investim strategjik i familjes sonë politike, janë një gjeneratë drejtuesish që ka shumë për t’i dhënë edhe kësaj familje, edhe Shqipërisë, në parlament, në qeveri, prapë në të ardhmen. Të gjithë ata që kanë 5 vjet në kabinet do t’ua lënë vendin të tjerëve. E për të gjithë, unë do të bëj një falënderim të posaçëm, duke ju thënë se për punën dhe rezultatet e gjithsecilit mund të mbaja një fjalë më vete, sepse janë punë dhe rezultate të çdo sektori. Dua ta filloj me Linditën, sepse në asnjë mënyrë e vërteta nuk është ajo që duket në këtë moment.

Lindita është vënë në qendër të ciklonit. E për më tepër, s’dua që ta harrojë njëri se askush nuk kërkoi as ndryshimin e qeverisë, as ndryshimin e ministrave.

Reforma në Arsimit është një nga reformat më të thella dhe më kuptimplota në adresimin e fundit të tranzicionit. Fola për mësuesit, është padyshim meritë e lidhshpirt të Linditës. Librat; deri dje, fëmijët e këtij vendi futeshin në një xhungël librash që ishin dezinformues, mashtrues. 600 tekste u hoqën nga mësuesit me ato altertektet e famshme, kur në fillim të rrugës, Shqipëria ishte çliruar në 28 nëntor; në fund të rrugës të shkolla tjetër ishte çliruar në 29 nëntor. Varej çfarë libri historioi zgjidhte njëri e çfarë tjetri. Sot jemi në mbyllje të një cikli transformimi rrënjësor, ku fëmijët e Shqipërisë studiojnë me librat e



Kryeministri Edi Rama

Oksfordit, të Kembrixhit të Pearson. Hyrja në universitet; më thoni, kush nga ju dhe cili shqiptar besonte se do të vinte dita që në universitetet e këtij vendi, njerëzit të mos hynin sipas statusit social, të mos hynin sipas xhepit, të mos hynin sipas partisë, por të hynin sipas meritës, sipas notës. Është sistemi që krijoi Lindita Nikolla.

Sistemi i hyrjes në universitet me platformën dixhitale, sistemi ku prej 2 vitesh nuk kemi asnjë ankesë. As edhe një. Nuk është metaforë, është fakt, sepse gjithsekush e shikon në ekran pozicionin e vet dhe askush nuk e parakalon dot tjetrin, le të jetë djali i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Edhe ligji për Arsimin e Lartë, që sot është bërë shënjestër, është një ligj që garanton fundin e tranzicionit në Arsimin e Lartë. Na duhet vetëm ta zbatojmë. Është meritë e Lindita Nikollës që ka udhëhequr projektin më të konsultuar me të gjithë. Ata që thonë që nuk e dimin e që nuk e kishim dëgjuar, janë tipikët që bëhen të interesuar, kur duan të kapin ndonjë copë për vetë. Ligji ka ardhur në Parlament, i mbështetur nga të gjithë rektoratet e nga të gjithë dekanatet. Imagjinoni, konsensusi mes gjithë shqiptarëve të përfshirë në botën akademike. Patjetër ka pasur nga ata që e kanë kundërshtuar, normal, por sigurisht që paralelisht me gjithë këtë punë dhe paralelisht me gjithë këtë kontribut, ka shumë gjëra të tjera që presin për lidhshpirtin dhe për kontributin e Linditës, që nga udhëheqja e një garku ku ne duhet të fitojmë të gjitha bashkë, në Lezhë, tek Kuvendi. Besa Shahini do të zëvendësojë Lindita Nikollën. Besa Shahini është zëvendësimin e arsimit, është me një karrierë akademike, besoj që flet vetë për të dhe ka të gjithë kapacitetin për të marrë stafetin dhe për të çuar përpara reformat e për të rritur efikasitetin e punës së Ministrisë së Arsimit. Arben Ahmetaj pa diskutim që ka një rol absolut në gjithçka që lidhet me shifrat domethënëse e me faktet domethënëse që për fat të keq e humbasin rëndom domethënia në vorbullin e kuzanit dhe në atmosferën e acarimit legjitim që kanë njerëzit. Nuk dua të numëroj shumëçka është bërë, por dua të them vetëm që, nëse sot shifrat janë të atilla që Shqipëria pati një sukses në tregjet e



kapitaleve në botë, me Eurobondin, merita kryesore i takon Ministrisë të Financave. Ministria e re e Financave do të jetë Anila Adenaj. Anila është drejtuese aktuale e Fondit të Shërbimit Kombëtar Shëndetësor. Edhe ajo ka një eksperiencë të gjatë si financiere, eksperiencë ndërkombehtarë dhe kombëtare. Dhe për ministrat e riñ do të ketë kohë për të bërë prezantime më shteruese.

Ditmir Bushati, ka pa diskutim edhe ai merita të pamohueshme në gjithë rrugën e deritanishme, në dinamiken e re të politikës sonë të jashtme, reputacionin e vendit në rajon dhe në kancelarinë europiane, shërbimet e reja konsulllore, por është koha që Ditmiri t'i përkushtohet Shkodrës, me kohë të plotë dhe të japi kontributin e vet në Këshillin Kombëtar të Integritimit, ku ka gjithë eksperiencën dhe kapacitetin për të qene një vlerë e shtuar. Gent Caka do jetë ministri i ri për Europën dhe Punët e Jashtme. Është zëvendësministri aktual që ndjek integrimin dhe ai ka një eksperiencë akademike të shkëlqyer dhe besoj se e ka të gjithë kapacitetin për të marrë stafetin e për ta çuar më tej, punën e nisur. Dua të them dy fjalë për Damian Gjukurin, pasi për fat të keq, ajo që ka ndodhur së fundmi ka errësuar padrejtësisht dhe përkohësisht gjithë kontributet dhe figurën e tij. Damian Gjukurit është ministri që ka lënë një shenjë të pashlyshme me reformimin rrënjësor të sektorit të energjisë dhe pavarësisht se çfarë mund t'i atribuohet lidhshpimit tim dhe kokëfortësisë sime në atë drejtim, mund t'ju them pa asnjë lloj modestie se pa Damianin, ajo reformë do të ishte e pamundur. Nuk dua të fyhet asnjë koleg tjetër, por askush tjetër nga ministrat me të cilët kam punuar, nuk i ka kapacitetin e tij drejtues dhe menaxhuese, askush. Është një investim i padiskutueshëm i Partisë Socialiste dhe jam i bindur që dhe historia e mahisur politikisht e lotit të Unazës, ku një kompani doli me dokumente të falsifikuara, do zbardhet deri në fund dhe do provojë pajafajësim totale të ministrat. Në një familje, në një organizatë, në një vend, në një komunitet çfarëdo, njerëzit nuk mbajnë përgjegjësi për gjithçka ndodh, por mbajnë përgjegjësi për mënyrën sesi reagojnë kur gjërat ndodhin dhe dua t'ju them të gjithëve se një kompani, apo shumë

kompani me dokumente të falsifikuara, nuk përbën absolutisht asnjë risi, as në Shqipëri, as në Amerikë, as në botë.

Ndryshimi në Shqipëri është se një kompani me letra të falsifikuara privatizoi një nga asetet më të mëdha strategjike të këtij vend në kohën e atyre që sot mbliken bashkë me protestuesit profesionistë të administratës së Bashkisë Kamëz dhe bërtasin për vjedhjen 40 milionë dhe jo që nuk u hyri asnjë gjemb në këmbë, por as garancia e vendosur në kontratë nuk u mor. E sigurisht, mashtruesit ikën në drejtim të paditur, të ndihmuar nga ata me të cilët ishin të lidhur në krye të vendit. Në rastin në fjalë, reagimi ynë ka qenë i menjëhershëm dhe patjetër është fat që hetimet janë të dyanshme, janë në Shqipëri, janë dhe në Amerikë dhe do ta zbardhim deri në fund të gjithë zinxhirin e fajit. Pa diskutim, nuk ka sesi të ndodhë ndryshe. Ndërkohë, ne po punojmë për të marrë garancinë nga kompania e sigurimeve, është rreth 2 milionë euro, në mos gabohem dhe me të do krijojmë një fond strehimi për banorët në nevojë që preken nga projektet e punëve publike. Me radhë të gjitha, edhe gjatë këtij viti, për infrastrukturën aeroportuale, për ujin, për hekurudhën, janë të gjitha punë të bëra me shumë përkushtim, me shumë mençuri, në një trase që është e shtuar për pasardhësin, ndërkohë që pa diskutim, Damianin do të vazhdojë të bëjë me po aq përkushtim dhe jam i bindur edhe me shumë sukses, punën e tij si udhëheqës në Qarkun e Vlorës, ku nuk diskutohet që ne do t'i fitojmë të gjitha bashkë dhe ku kemi nevojë të bëjmë një reformë të thellë të administratës atje. Një reformë të thellë për t'i dhënë çdo zyre, fytyrën e ambicieve tona për gjeneratën tjetër e për t'i dhënë çdo zyre, pasqyrën ku studentët protestues të Universitetit "Ismail Qemali" do donin të shikonin të ardhmen e tyre.

Ministria e re e Infrastrukturës dhe Energjisë do jetë Belinda Baluku. Belinda është drejtoria aktuale e "AlbControl" dhe besoj që i ka të gjitha atributet për ta drejtuar me sukses Ministrinë e Infrastruk-

"Ndryshimet në qeveri, reflektim që do na çojë në mandatin e tretë"

# "Studentëve u ktheva faqen tjetër, shumë e drejtë që acarohen me ne"

"Kur nisi protesta, mora Elion e i thashë: Ç'bën?"

### UZURPIMI I PUSHTETIT

"Partia Socialiste nuk mund të shihet nëpër territore si një forcë uzurpatore e atij pushteti në territor. Nuk mund të shihet si forcë uzurpatore e hipotekave, e ALUIZNI-t, e ISSH-ve, e rr, rr, rr-ve dhe da, da, da-ve. Kjo do të mbarojë!", tha Rama.



Protesta e studentëve

turës. Nuk po zgjatëm me prezantime, sepse e njihim që të gjithë dhe e njohim që të gjithë. Niko Peleshi ka qenë një bashkëpunëtor absolutisht që të gjithë do donin ta kishin. Unë pata fatin që e pata për katër vjet si zëvendëskryeministër e gjatë këtij viti e pak të mandatit të dytë si ministër të Bujqësisë. Bledi Çuçi do zëvendësojë Niko Peleshin si ministër i Bujqësisë.

Ndërkohë që Nikos i bie barra të sjellë nga Qarku i Korçës një rezultat edhe më të mirë se ai i vitit 2017, së bashku me të gjithë kontributet në Kuvend dhe në debatin publik. Edhe Mirela Kumbaro besoj që meriton të gjithë respektin për një punë të madhe që është bërë. Është një përmbysje totale në të gjitha drejtimet. Trashëgimia kulturore sot është më nën kujdes se asnjë herë tjetër. Janë të panumëra monumentet e shpëtuara, edhe pse nuk diskutohet që asnjëherë nuk janë mjaft. Muzeumet e reja të ndërtuara. Teatrot që janë ndërtuar apo në ndërtim, që nga 'Art Turbina' tek

MINISTRAT NË TERREN

"Ne kemi ministra që janë udhëheqës të qarqeve, që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe të suksesshme për zgjedhjet. Nëse do t'u bëjmë llogarinë sa ditë kanë kaluar si udhëheqës qarqesh, është deficit shumë i madh", deklaroi kryeministri.

marrjen. Do të rikthejmë ministrin për Marrëdhëniet me Parlamentin. Besoj që është një domosdoshmëri. Unë dua ta them sot, shumë hapur, vlera më e madhe e luajalitetit ndaj Partisë Socialiste, në eksperiencën time si kryeministër, është ky grup parlamentar që kemi sot. Jam shumë i keqardhur që ky grup parlamentar goditet shpeshherë në mënyrë barbare nga mushkujt që kemi fatqegjësimit të kemi opozitë, por grupi parlamentar përbëhet nga njerëz me një sens përgjegjësie politike të lartë, me një sens luajaliteti të lartë, të cilët kanë merituar më shumë nga qeveria dhe nga çdo ministër. Jam i bindur, janë të kënaqur që shumë ministra do t'i kenë në gjirin e tyre për t'i rehabilituar nga pikëpamja e humanizmit dhe për të përfituar nga eksperiencat e tyre. Por, në këto kushte, unë dëshiroj që Elisa Spiropali të bëhet ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin e të jetë një urë e vazhdueshme komunikimi mes të dyja palëve, si një deputete shumë aktive e grupit dhe si një kolege, të cilën e respektojnë dhe e vlerësojnë që të gjithë.

Tani, në fund fare, kam edhe një ndryshim që e konsideroj kyç. Erion Braçe do të jetë zëvendëskryeministri i ri i qeverisë, sepse është koha që të shërbimeve, në shërbime për njerëzit, në shërbime dimjtoze dhe për të dhënë të gjithë kontributin e tij, besoj unikal, në pastrimin e administratës nga hajdutët, nga parazitët dhe nga gjithfarëloj fundërrinash që vazhdojnë të cenojnë drejtëpërdrejtë qytetarin, pa pikën e turpit, duke tundur lloj-lloj flamujsh, që nga flamuri i Partisë Socialiste, tek flamuri i krushqisë, tek flamuri i vëllazërisë, tek flamuri i radhës. Është koha që ndarja me këtë lloj qenieje të jetë drastike në

çdo pjesë të territorit. Është koha që dimensiononi i ri që ka krijuar Platforma e Bashkëqeverisjes të shtrihet e të kthehet në normë kudo, për këdo që guxon të cenojë një qytetar. E po ashtu, Erioni do të udhëheqë zbatimin e programeve të veçanta, siç ka udhëhequr programin për adresimin e 8 kërkesave të studentëve dhe të gjithë atyre elementeve të tjerë që do të jenë në dokumentin e Paktit për Universitetin. Besoj që ai do të jetë edhe dokumenti i parë që si zëvendëskryeministër, Erioni do të prezantojë publikisht, kur të jetë finalizuar në javët e para të janarit. E falënderoj shumë Senidin për të gjithë kontributin e saj dhe besoj shumë që ka qenë një eksperiencë pozitive e dyanshme. Sikundër besoj që edhe Senida e kupton shumë mirë që për ne është themelore që ajo, Ditmiri dhe të gjithë ata që janë dhe kanë përgjegjësi të ridimensionojnë reputacionin e Partisë Socialiste në qeverisjen qendrore në Qarkun e Shkodrës, të bëhet realitet një orë e më parë.

Blendi Klosi e di afatin që ka deri në fund të qershorit. E di dhe detyrën që ka dhe nëse do ta zbatojë detyrën që ka, qershori do jetë thjeshtë gëzim për fitoren e zgjedhjeve në gjithë Qarkun e Beratit dhe nuk do ketë asnjë lajm tjetër për të. Po kështu, edhe Ogerta e di shumë mirë se çfarë pritet prej saj në gjashtë muajt e ardhshëm. Kjo ishte paraqitja që unë kisha, duke ju siguruar që ajo kisha nisa të them dhe ajo me të cilën dua ta mbyll, që ky është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm për Partinë Socialiste dhe është një mundësi e jashtëzakonshme, për mua, nuk është një fjalë goje, por është një bindje e thellë. Me besimin që qeveria e re do të krijojë më shumë hapësirë për më shumë ndërveprime, pasi një pjesë e atyre që sapo thashë do të lënë qeverinë, do të kenë shumë më tepër fokus në udhëheqjen e partisë, në udhëheqjen e fushatës dhe me garancinë që të gjithë ju, asnjë ministër, qoftë dhe i sapoardhur, nuk do të tolerohet në rast se nuk do t'i mbajë parasysh të gjitha ato për të cilat është bërë ky ndryshim.

Edhe një herë ju uroj të gjithëve Gëzuar Vitin e Ri!

## NDRYSHIMET REAGIMET

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, i quan ndryshimet në qeveri tallje të Edi Ramës me shqiptarët. Sipas tij, ndryshimet në qeveri tregojnë degradimin e plotë të PS-së. Përpara mediave, z.Basha u shfaq dje me akuza ndaj ministrave të shkarkuar, ndaj të cilëve kërkoi që të veprojnë drejtësisë. Basha tha se ministrat e larguar janë njerëz të korruptuar dhe të inkriminuar. Ndaj sipas tij, shkarkimi i tyre nuk mjafton, ata duhet të dalin para drejtësisë. "Edi Rama sot mund të kishte vendosur ministër shoferin e tij, mund të kishte vendosur ministër parukierin e tij. Ministrat e larguar janë njerëz të korruptuar, ata duhet të dalin para drejtësisë. Me aktin e sotëm, (djeshëm) Rama tregoi se nuk ka nevojë për ministra. Sipas tij, u pa qartë se Rama nuk ka nevojë për ministra, por qeveris direkt me oligarkët dhe me krimin. Ai qeveris me oligarkët dhe krimin. Ai vendos kë të dojë dhe nuk ka kush ta ndalojë. Edi Rama sot mund të kishte vendosur ministër shoferin e tij dhe parukierin e tij dhe nuk ka kush ta ndalë. Ministrat e larguar janë njerëz të korruptuar dhe të inkriminuar, largimi i tyre nuk mjafton. Ata duhet të dalin para drejtësisë. Por me aktin e sotëm (djeshëm) Edi Rama dëshmoi se ai nuk ka nevojë për ministra, ai qeveris direkt me oligarkët dhe krimin. Me ata përcakton se si grabiten pasuritë dhe paratë e shqiptarëve, me ta ka qeverisur në këto 5 vite dhe me ta do të vazhdojë të qeverisë", deklaroi z.Basha. Kryetari i PD-së ndryshimet në qeveri i cilësoi si tallje me shqiptarët. Në bindjen e kreu të PD-së, ndryshimet në qeverisje në vetvete tregojnë gjendjen e rënduar psikike të Edi Ramës. "Ndryshimet në qeverisje tregojnë gjendjen e rënduar psikike të Edi Ramës: i degraduar nga veset, i paralizuar nga paafërsia totale, i mbushur me urretje për njerëzit dhe i krimbur nga paratë që ka vënë, ai po sillet siç sillen njerëzit e degraduar kur i vjen fundi, po bën aktet e një të marri", deklaroi z.Basha. Pa shqiptuar nuk la as emrat e rinj të emëruar në ekzekutiv. Sipas Lulzim Bashës, ministrat e rinj janë një përzierje njerëzish të paafë, anonimë dhe disa thellësisht të korruptuar. "Sot (dje) pamë një grup njerëzish që nuk kanë asnjë rol tjetër përveçse të duartroskasin sjelljen e Edi Ramës me këtë parti si një plaçkë private që ai e përdor për të marrë vendime që i shërbejnë

Kreu i PD: Ministrat e larguar të inkriminuar, duhet të dalin para drejtësisë

# Largimet, Basha: Ministrat e rinj, të paafë dhe të korruptuar

"Rama po bën aktet e një të marri"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

### AKUZA

"Ajo që u ka ofruar shqiptarëve është një përzierje njerëzish të paafë, anonimë dhe madje disa, thellësisht të korruptuar. Por roli i këtyre njerëzve nuk është gjë tjetër veçse të shërbejnë si fasada e qeverisjes së Edi Ramës me oligarkët dhe me krimin, me përfaqësuesit e krimin të organizuar", tha z.Basha.

### "Ish-ministrat erdhën, vodhën, ikën!"

Berisha: Edvini përmbysi qeverinë, lidhjet e tij me ministrat e rinj



Ish-kryeministri, Sali Berisha

Ish-kryeministri i vendit, Sali Berisha, shprehet se shefi i ekzekutivit përmbysi qeverinë përpara se të largohet edhe ai vetë për në azil. Ai shprehu bindjen se zëvendësuesit e rinj në kabinetin qeveritar së shpejti do ta përcjellin edhe Ramën për në aeroport me synim marrjen e azilit. "Për narkoministrat që u larguan, për shumicën dërrmuese të tyre me tri fjalë mund të thuhet: erdhën, vodhën, ikën! Midis tyre kishte përfaqësues të klaneve kriminale mafioze më të rrezikshme të Shkodrës, Korçës, Elbasanit si dhe hajna të kalibrit botëror, tradhtarë që shiten 2000 km det Greqisë si Niko Pelesh, Ditz Bushati, Dam Gjikonuri, hajna të kalibrit botëror si Gjikonuri, Ahmetaj, ndrikulla të cilat me paratë e taksapaguesve ndërtuan vila luksoze apo lumturuan veten dhe vëllain e tyre etj., etj. si Nikolla dhe Kumbara, Felaj (të cilës për gjokat që priste, i mori burrin peng mafia). Zëvendësuesit, që së shpejti do e përcjellin Ramën gjër në aeroport për në azil politik, gjenden

vetëm atij dhe njerëzve me të cilët ai grabit Shqipërinë, oligarkëve dhe kriminelëve. Ajo që u ka ofruar shqiptarëve është një përzierje njerëzish të paafë, anonimë dhe disa thellësisht të korruptuar.

Ndryshimet në qeveri tregojnë degradimin e plotë të Partisë Socialiste. Por, roli i tyre është vetëm të shërbejnë si fasadë e qeverisjes së Edi Ramës me oligarkët dhe me përfaqësuesit e krimin të orga-

krimale të Gjirokastrës dhe Tepelenës, Çuçi; ndrikull Belinda, e denonuar për afëra korruptive; përfaqësuesi i kryeargatis Baton Haxhia, në Ministrinë e Jashtme, autor i deklaratave skandalozë dhe duket idhtar i copëtimit të Kosovës, Caka; ndrikull Spiropali, famoze për pasuritë përrallore që ka vënë në dogana, mori

nizuar. Në këtë kuadër e ka më të lehtë që vendimet që i merr bashkë me oligarkët dhe kriminelët t'i vulosin", u shpreh kreu i opozitës. Kryeministri i kujtoi se largimet në qeveri paracaktjnë fundin e



### AGRON SHEHAJ

"Ndryshimet në qeveri janë përsëritje e skenarit 'Tahir'i': Rama largoi disa ministra të inkriminuar para se faktet e inkriminimit të tyre të bëhen publike dhe bashkë me ta hoqi edhe ca të tjerë për të dhënë idenë e reflektimit për të përmirësuar qeverisjen. Ndryshimet janë një manovër dinake për të ndërtuar një fasadë të re, nën të cilën Rama do të bashkëqeverisë me krimin dhe oligarkët", tha deputeti i PD-së.

shpërblimin nga Skënderbuçi i saj; ndrikulla e Financave Dena është kryemike-sha dhe emërtesë e vetë Linda Ramës, nuk ka nevojë për komente si dhe ndrikulla të tjera. Shkurt, ky është kabinetin i kapitullimit apo i funeralit politik të Kallam Dëshatutakut para largimit të tij nga Shqipëria", shkruan Berisha.

tij politik. "Asgjë nuk e fsheh dot atë që shqiptarët e kanë kuptuar; peshku është qelbur nga koka", deklaroi ai. Basha u shpreh se ndryshimet në qeveri tregojnë degradimin e plotë të PS.



Presidenti Ilir Meta dje në mencën "Shërbesa e dashurisë" e Mitropolitë së Korçës



Kryemadhi: Rama ndërroi pjesë të lavatriçes së pastrimit të parave

Për Monika Kryemadhi, qeveria ka rënë. Duke komentuar ndryshimet në kabinetin qeveritar, kryetarja e LSI tha se Rama ka ndërruar vetëm disa pjesë të lavatriçes së pastrimit të parave të pista. Kryemadhi theksoi se kjo qeveri ka rënë si pasojë e skandaleve në të cilat është përfshirë. "Qeveria ra sepse ky asnjëherë nuk përmend se sa shumë taksa paguajnë shqiptarët, por përditë bërtet dhe ulëret sikur ky ka bërë uljen më të madhe të taksave. Në fakt, kjo nuk është një ndryshim qeverie që mundohet të shpjojë Edi Rama, por kjo është një rënie e qeverisë, e cila ra si rezultat i skandaleve korruptive të qeverisë së Edi Ramës. Edi Rama harroi të thoshte përpara partisë së Surrellit se qeveria duhet t'u shërbejë qytetarëve të saj. Por përkundrazi, Rama ndërroi pjesë të lavatriçes të pastrimit të parave të drogës, sepse mendon që duke ndërruar disa pjesje dhe duke ndërruar detërgjentin, mund të vazhdojë të pastrojë paratë, por harron që duhet larguar lavatriçja e vetme që kanë shqiptarët sot, e cila ka emrin e Edi Ramës", deklaroi Kryemadhi.



Presidenti: Bashkëpunim me opozitën dhe grupet e interesit për zbatimin e ligjeve

# Ndërrimi i kabinetit, Meta: Të ndryshojë filozofia e qeverisjes

"Të paktën të ndjekim modelin e Maqedonisë"

Valentina Madani

Dekretet me emrat e ministrave që ikin dhe atyre që vijnë do të jenë shumë shpejt në tavolinën e tij, por presidenti Ilir Meta ka bindjen se nuk është i rëndësishëm ndryshimi i emrave, por i filozofisë së qeverisë. Duke komentuar ndryshimet e qeverisë "Rama", presidenti Ilir Meta shprehet se me rëndësi shihet ndryshimin e filozofisë së qeverisjes. Sipas tij, filozofia e qeverisjes duhet të jetë bashkëpunuese me opozitën dhe grupet e interesit, me qëllim krijimin e ligjeve të mira dhe zbatimin e tyre. Vetëm kjo sipas Metës, do të na ndihmonte në konsolidimin e shtresës së mesme si dhe të evitim të një ndarje sociale tepër të rrezikshme për shoqërinë tonë "Për mua është thelbësore të ndryshojë filozofia e qeverisjes, e cila duhet të jetë një filozofi bashkëpunuese. Bashkëpunuese me opozitën, bashkëpunuese me grupet e interesit, për bërjen e ligjeve më të mira dhe zbatimin e tyre", deklaroi kreu i shtetit. I pyetur nga gazetarët pas një aktiviteti në Korçë, Meta sjell si shembull ministrin e Bujqësisë. "Meqenëse edhe vetë Korça e lidh mjaft fatin e saj me zhvillimin e bujqësisë e të industrive që bazohen tek ajo, mund të them që mund të ndryshohet çdo gjashë muaj ministri i Bujqësisë, por në rast se nuk ndryshohen politikat për zhvillimin e bujqësisë, për mbështetjen e bujqësisë, ndryshimet e emrave nuk u vlejné as fermerëve, as ekonomistëve të vendit", theksoi presidenti. Z.Meta vuri në dukje se nuk janë të rëndësishëm emrat që vijnë në qeveri, por raportit që krijojnë me qytetarët. "Për mua nuk është e rëndësishme se nga vijnë e si vijnë apo si ikin ministrat. Për mua është e rëndësishme të reflektojmë dhe të përmirësojmë raportin me të vërtetën dhe me njerëzit", u shpreh kreu i shtetit. Z.Meta u pyet edhe për dy ministrat që vijnë nga Kosova. "Nuk kam asnjë informacion për këtë çështje. Për mua nuk është e rëndësishme se nga vijnë e si vijnë apo si ikin ministrat. Për mua është e rëndë-



Presidenti Ilir Meta

**DEKLARATA**

"Për mua është e rëndësishme të ndryshojë filozofia e qeverisjes, e cila duhet të jetë bashkëpunuese me opozitën dhe grupet e interesit për të bërë ligje të mira, bashkëpunuese me institucionet e pavarura, për të sjellë ato ndryshime për të cilat kanë nevojë njerëzit më në vështrësi", deklaroi presidenti.

## Reagimi



PETRIT VASILI

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, reagoi lidhur me ndryshimet e bëra në kabinetin qeveritar. Vasili shprehet se qeveria ra, tani është radha e kryeministrit. Kryeministri Rama largoi dje 7 ministra të kabinetit të tij qeveritar si dhe zv.kryeministren, Senida Mesi, ndërsa dha paralajmërim për dy ministra të tjerë.



## Ndryshimet, Paloka: Ik Edvin se nuk të pastron më asgjë

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, reagoi pas ndryshimeve të qeverisë, të prezantuara dje nga kryeministri Edi Rama. Duke përdorur një fjalë popullore, Paloka i kërkon Ramës të ikë, pasi nuk e shpëton dot më asgjë. "Vetëm një shprehje e popullit mund të më vijë në mend tani për ndryshimet në qeveri të Ramës: 'Të lash m... me sh...'. Ik Edvin se nuk të pastron e nuk të shpëton më asgjë...", shkruan Paloka. Kurse deputeti tjetër i PD-së, Tritan Shehu deklaroi: "Si Honeckeri dikur në ikje... O Shqipëri e mjera Shqipëri... po këndohet sot (dje) duke dëgjuar ndryshimet masive të një qeverie të dështuar; por që 'konservon' kryeministrin. Ekzaktesisht këtë bëri dhe Honecker me qeverinë e tij në prag të kolapsit të RDGj, por me epilog të shpejtë arratisjen e tij me rrugë ajrore drejt Moskës".

**NDRYSHIMET**

Duke përdorur një fjalë popullore, Paloka i kërkon Ramës të ikë, pasi nuk e shpëton dot më asgjë. "Vetëm një shprehje e popullit mund të më vijë në mend tani për ndryshimet në qeveri të Ramës: 'Të lash m... me sh...'", shkruan Paloka.

## Propozimi i emigrantit: Të krijohet një parti nacionaliste

### Emigrantët në protestë kundër krimit, u bashkohen banorët e "Astirit"

Banorët e "Astirit", emigrantët, artistët dhe studentët protestuan dje para Kryeministrit. Protesta e djeshme bashkoi disa kauza, për të cilat ata kërkojnë zgjidhje nga kryeministri, përfshi atë kundër varfërisë dhe krimit. Banorët e "Astirit" pasi bllokuan rrugën, për disa minuta u bashkuan protestuesve të tjerë. Duke komentuar ndryshimet në qeveri, banorët thanë se kjo nuk ndryshon asgjë. "Është ai që duhet të largohet që të rregullohet Shqipëria. Ai po bën 'shoë' dhe ministrat janë kukulla të Ramës", tha një banor. Ndërsa një emigrant, duke iu drejtuar kryeministrit tha: "Garantuan protestën e ekstremitëve grekë dhe kërkuat të ndaloni protestën e patriotëve shqiptarë. Zoti kryeministër, ne jemi këtu. Ju thatë që nuk do ketë protestë. Ne jemi këtu. Jemi këtu për studentët, për banorët e



'Astirit', për minatorët, për naftëtarët, për pensionistët dhe për çdo shtresë që ndihet e shtypur këtu", tha një emigrant. Një tjetër emigrant propozoi që të krijohet një parti nacionaliste. "Duhet patjetër të formohet një parti, që i djeg zemra. Një parti nacionaliste, që e ka emrin vetëm 'Shqiptar'. Nuk duam një kryeministër që thotë njëherë jam pujan, njëherë mirditor. Nuk na duhet një kryeministër i ardhshëm si Lulzim Basha, që kur u zgjodh kryetar bashkie, tha do ketë ndry-

shim. Kur e pashë që Basha fle gjumë në zyrë, nuk desha ta besoj, por sot e kuptoj. Turp marrëveshja e dhjetorit 2014 kur Basha mbylli gojën. Unë e di që shumica e njerëzve nuk vijnë këtu se thonë për kë të votojmë tani? Prandaj i bëj thirrje, parti nacionaliste. Nuk ka rrugë tjetër. Kështu e votoi edhe Amerika Donald Trump, që ishte vetëm një biznesmen dhe nuk ishte i përzierë në politikë, por i digjte shpirti për Amerikën".

sishme të reflektojmë dhe të përmirësojmë raportin me të vërtetën dhe me njerëzit", u shpreh Z.Meta. Dekretimi i fundit nga Presidenti Meta ishte ai i Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm, që shkaktoi një përplasje mes tij

dhe kryeministrit Rama. Kryeministri Rama largoi dje 7 ministra të kabinetit të tij qeveritar si dhe zv.kryeministren Senida Mesi, ndërsa dha paralajmërim për dy ministrat të tjerë. Gjithashtu, u emërua Erjon Braçe si

zv.kryeministri i ri si dhe riktheu Ministrinë e Marrëdhënieve me Parlamentin duke emëruar në këtë post Elisa Spiropalin. Të gjithë ata që kishin 5 vjet në kabinet janë larguar për t'u lënë vendin të tjerëve.

Krimi në Bulqizë/ 40-vjeçari Adriatik Jella vritet me thikë pasi plagosi dy familjarë të gruas

# Vritet 40-vjeçari, i preu veshët kunatit

## Dhëndëri i familjes u konfliktua me familjarët e bashkëshortes

Një ngjarje në përmasat e makabres ka ndodhur në Bulqizë. Dhëndri është vrarë nga njerëzit e nuses në banesë e tyre, ndërkohë që të plagosur kanë mbetur edhe dy persona të tjerë. "BalkanWeb" mëson se gjithçka nisi një ditë më parë, kur pas një shërri për motive të dobëta Adriatik Jella, rreth 40 vjeç, i preu veshët vëllait të bashkëshortes. Ngjarja ndodhi në Maqellarë të Dibrës. Gazetari Enver Doçi ka siguruar për "BalkanWeb" të gjithë ngjarjen që rrodhi më pas, që u pasua nga të tjera krime. Mësohet se Jella u nis drejt fshatit të gruas së tij, Gjoricë dhe sapo hyri në banesë, plagosi një prej anëtarëve të kësaj familjeje. Duke u gjendur në këto rrethana, thuhet se vjehëri i tij ka marrë një dru dhe e ka goditur në kokë dhëndrin.



Vëllai i bashkëshortes së viktimit



### NGJARJA

Jella u nis drejt fshatit të gruas së tij, Gjoricë dhe sapo hyri në banesë, plagosi një prej anëtarëve të kësaj familjeje. Duke u gjendur në këto rrethana, thuhet se vjehëri i tij ka marrë një dru dhe e ka goditur në kokë dhëndrin.

### ARRESTIMI

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda në D.V.P. Dibër, në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Dibër arrestuan në flagrancë shtetasit V.Ç., 68 vjeç, banues në Topojan, për veprën penale të "Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare" në bashkëpunim.

Ky i fundit humbi jetën duke shkuar në spital. Doçi raporton për "BalkanWeb" se Jella ishte person me precedentë penalë, ndërsa një muaj më parë ishte arrestuar për dhunë në familje. Paraprakisht thuhet se krimi makabër ndodhi pas një shërri mes kunatit dhe tij, pasi ai i kishte kërkuar llogari se pse i kishte dhunuar motrën. Aktualisht policia po heton për ngjarjen në fjalë, ndërkohë që tre persona janë arrestuar.

### NJOFTIMI I POLICISË

Policia zbardh e dokumenton plagosjen me mjete prerë të 2 shtetasve, si dhe vrasjen me thikë të autorit të dyshuar të plagosjes së tyre. Arrestohen në flagrancë 3 shtetas. Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda në D.V.P. Dibër, në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Dibër arrestuan në flagrancë shtetasit V.Ç., 68 vjeç, banues në Topojan, për veprën penale të "Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare" në bashkëpunim. G.D., 28 vjeç dhe A.D., 34 vjeç, (vëllezër) për veprën penale të "Vrasjes me dashje", të kryer në bashkëpunim.

### NGJARJA

Një ngjarje në përmasat e makabres ka ndodhur në Bulqizë. Dhëndri është vrarë nga njerëzit e nuses në banesë e tyre, ndërkohë që të plagosur kanë mbetur edhe dy persona të tjerë. "BalkanWeb" mëson se gjithçka nisi një ditë më parë kur pas një shërri për motive të dobëta Adriatik Jella, rreth 40 vjeç, i preu veshët vëllait të bashkëshortes. Ngjarja ndodhi në Maqellarë të Dibrës. Gazetari Enver Doçi ka siguruar për "BalkanWeb" të gjithë ngjarjen që rrodhi më pas, që u pasua nga të tjera

## Fidane Cidhnaku rrëfen si viktima i plagosi djalin me thikë

### "Do ju përdhunoj femrat", vjehëra e vrasësit: Kërcënime makabre

Do ju zhvarros të gjithëve. Do ju vras fëmijët". Kështu deklaroi se është kërcënuar vjehëra e Adriatik Jellës, i cili mbeti i vrarë pas një konflikti të ashpër me familjen e gruas së tij. Ngjarja e rëndë ndodhi në Topojan të Bulqizës, ku përveç 40-vjeçarit, u plagosën rëndë 2 persona të tjerë. Fidane Cidhnaku, në një intervistë për gazetarin e "News 24" dhe "BalkanWeb", Enver Doçi tregoi detaje nga ngjarja në fjalë, që nisi me plagosjen e djalit të saj, plagosjen e krushkut të saj dhe më pas vrasjen e dhëndrit. Vjehëra e viktimit tha se gjithçka kishte nisur pasi dhëndri i kishte plagosur djalin, pas kërcënimeve të vazhdueshme që u bënte atyre pa shprehur asnjë shprehje të urrejtjes.



Vjehëra e viktimit, Fidane Cidhnaku, duke folur për "GSH"

goditi me dy thika, i preu edhe veshët. Djalin ma ka plagosur në Maqellarë dhe ma ka lënë pa ndjenja. Djalin e kanë çuar në spital pa ndjenja dhe të mbuluar në gjak.

### Çfarë ndodhi më pas?

Ne shkuam në polici, por ajo nuk na u përgjigj hiç. Pasi më plagosi djalin, ai tha: "Nuk mbaron me kaq, kam më. Do vijë t'u bëjë Kosovë." ("Do vijë t'u përdhunoj fëmijë dhe gra" ishte pohimi i saktë i të moshuarës, jashtë kamerës). Na e tha me mesazh dhe drejtpërdrejt. "Unë do i vras të gjithë fem-

Duke u gjendur në këto rrethana, thuhet se vjehëri i tij ka marrë një dru dhe e ka goditur në kokë dhëndrin. Ky i fundit humbi jetën

bërë në Gjoricë, që e kishte dëgjuar një grua. Më pas na erdhi tek shtëpia. Pasi u fut në shtëpi, dhe ne kishim krushkë në shtëpi, pasi erdhën për t'u interesuar për djalin tim që u plagos, sepse është dhëndri i tyre. Adriatiku erdhi befaz dhe goditi me thikë Flamurin, (kunatin e djalit tim) që ishte duke folur me djalin tim që ta pyeste se si ishte gjendja e tij shëndetësore, por e goditi dy herë më thikë në bark dhe në vesh. E kanë çuar me avion në Tiranë. Është në gjendje kome.

duke shkuar në spital. Doçi raporton për "BalkanWeb" se Jella ishte person me precedentë penalë, ndërsa një muaj më parë ishte arrestu-

### NGJARJA

Vjehëra e viktimit tha se gjithçka kishte nisur pasi dhëndri i kishte plagosur djalin, pas kërcënimeve të vazhdueshme që u bënte atyre pasi ishte ndarë nga gruaja. Ajo tha se pak pasi Adriatiku kishte plagosur kunatin, ishte nisur drejt shtëpisë së tyre dhe më pas kishte plagosur vëllain e nuses së saj.

### Ju ka bërë presione?

Po, gjithmonë na bënte presione. Një ditë erdhi këtu dhe kërcënoi plakun tim: "O dua gocën, ose do t'ju shfaros krejt". Çfarë nuk na ka bërë! Nuk ka lënë pa shprehje fëmijë dhe nuse në këtë derë, çfarë nuk u ka thënë. Lerë gocës sime çfarë s'i ka bërë, lloj-lloj shpifje. Se u merrte me telefona dhe "Facebook". Edhe ma bëri vajzën zi, ma izoloi, na e bëri katran.

### Prej sa muajsh ka që ka ndodhur ky konflikt?

Prej gati 2-3 muajsh. Ai nuk është përgjigjur për fëmijët hiç. Fëmijët vinin

këtu dhe nuk donin që të shkonin tek shtëpia e tyre.

### A është arrestuar ndonjëherë viktima për dhunë në familje?

Vajza ime ka bërë denoncime, por policia s'ka bërë asnjë lëvizje. Dua që të merren masa të rrepta. Ai dhe plakun ma ka rrahur. Ai goditi vëllain e nuses sime. Erdhi në orën 16:00 dhe nisi të godiste, madje edhe plakun tim.

### Kush e goditi me dru Adriatikon?

E goditën vëllezërit e nuses, se panë djalin të plagosur dhe në gjak.

### Çfarë kërkoni nga drejtësia?

Ne nga drejtësia kërkojmë që të na ruajë. Ai ka farë e fis, ka nipër. Ne nuk kemi familje të madhe. Kemi frikë mos na bëjnë ndonjë krim tjetër.

### Ju kërkoni mbrojtje nga policia?

Po kërkojmë mbrojtje, se do na vrasin. Shikoni ku i kemi fëmijët...

### Brenda në shtëpi ndodhi ngjarja?

Unë e pashë të gjithë ngjarjen. Ndodhi tek salloni (korridor).

ari se pse i kishte dhunuar motrën. Aktualisht policia po heton për ngjarjen në fjalë, ndërkohë që tre persona janë arrestuar.



Shënjestra e atentatit të Laprakës: Patëm sherr 10 ditë më parë, nuk i njoh për emër autorët

# I plagosuri në atentat: Si ndodhi ngjarja

## Erion Benga: Nuk kam qenë unë i lidhur me 17-vjeçaren që u vra

Tirana u trondit nga një vrasje makabre në zonën e Laprakës, ku një 17-vjeçare humbi jetën pasi mori plumb në kokë dhe një 23-vjeçar u plagos. Pas ngjarjes së rëndë, ku i plagosuri flitej të ishte i dashuri i viktimës, Erion Benga ka folur për "Fax News" duke sqaruar më tej rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja, ndërsa hodhi poshtë pretendimet se ai ishte i dashuri i 17-vjeçares Briselda Gjinkollaj. Ai tha se e ndjera ishte vajzë me parime dhe vijonte shkollën, ndërsa prej 10 muajsh ishte në lidhje me një mikun e tij. "Nuk kam qenë asnjëherë i lidhur me 17-vjeçaren. Briselda kishte 10 muaj e lidhur me mikun tim. 10 ditë më parë kishim konflikt me personat në lokal, pasi ngacmuan Griseldën nga tavolina tjetër dhe kjo mjaftoi që të konfliktoheshim bashkë. Në ditën e ngjarjes ne shkuam si zakonisht në lokal, ata ishin aty. Nuk i njoh me emra asnjërin, vetëm fytyrat. Në momentin që



I plagosuri, Erion Benga

nisëm makinën, dëgjuam krisma, plumbi i parë goditi Griseldën në kokë, ra pa ndjenja. Ktheva kokën për ta parë, aty më qëlluan dy herë

në shpatull. Në makinë ishim katër veta, shoku im që ishte i lidhur me vajzën. Isha në gjendje të ngjisja makinën, shkuam shumë

shpejt në Spitalin e Traumës. Griselda ka qenë pa ndjenja që nga goditja në makinë. Griselda ishte një vajzë shumë e mirë, thashetheme kanë qarkulluar këto dy ditë. Nënë e ka në Itali, ndërsa babain e ka në Mirditë, ishte e ëma ajo që e ndihmonte nga ana financiare. Ajo në Tiranë jetonte me të vëllain dhe motrën e saj të vogël. Ajo ishte vetëm në shkollë, nuk ishte e punësuar dhe ishte vajzë me parime", është shprehur Benga për "Fax News". Ndërsa foli lidhur me akuzat e dy viteve më parë, ku sipas policisë kishte shantazhuar një femër me publikimin e një videoje intime, Benga u shpreh se kjo video nuk ekziston dhe gjithçka e kishte bërë për të marrë paratë që i kishin borxh. "Videoja e shumëpërfolur e para dy viteve nuk ekziston. Unë nuk kam kërcënuar asnjë njeri, thjesht kam kërkuar paratë e mia. Ia kisha dhënë një grupë 45-vjeçare borxh, thjeshtë kam kërkuar paratë e mia", - u shpreh Benga.

### Misteri, policia nuk publikon identitetin plotë

### Publikohet fotografia, kush është autori i vrasjes së 17-vjeçares

BalkanWeb" ka publikuar dje foton e 19-vjeçarit Robert B.P., i cili qëlloi me armë zjarri drejt një automjeti në Laprakë, ku si pasojë mbeti e vdekur adoleshentja Briselda Gjinkola dhe u plagos Erion Bengo, 23 vjeç. Një muaj më parë, adoleshentja u njoh me Erion Bengon, një 23-vjeçar, që dikur sipas "BW" kishte qenë në konflikt me ligjin. Ai kishte shantazhuar të ish-dashurën me video intime, duke i kërkuar para. Megjithatë, kjo nuk i pengoi të dy të nisnin një marrëdhënie, që përfundoi tragjikisht. Autorët e krimit të maskuar dhe me pistoletë u larguan në këmbë, ndërsa Erion Bengo u largua me makinën e tij ende pa mbaruar të shtënë në drejtim të kundërt për në Spitalin Ushtarak. Fatmirësisht falë ndërhyrjes në kohë të mjekëve ai mundi t'u shpëtojë plagëve të marra në qafë dhe shpatull, ndërsa vajza humbi jetën për shkak të plagëve të marra në kokë. "News 24" ka mundur të sigurojë një foto të automjetit të 23-vjeçarit, i cili qëndroi për disa orë në Spitalin e Traumës derisa u tërhoq nga policia. Në të janë të dukshme shenjat e plumbave. Mjetit i është thyer xhami anësor dhe ai i pasmë. Burime nga policia thanë se shënjestër e këtij atentati ishte 23-vjeçari. Një javë më parë ai ishte konfliktuar me disa persona, pasi këta të fundit i kishin ngacmuar të dashurën. Policia e Tiranës është fokusuar tek kjo pistë dhe ka shpallur si të dyshuar një 19-vjeçar nga Puka me banim në Tiranë. Policia në bashkëpunim me Prokurorinë po kalojnë në sitë të shkuarën e protagonistëve të kësaj ngjarjeje për të thelluar hetimet edhe në pista të tjera.

### Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

#### Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania Sh.A. ju njofton se duke filluar nga data **7 Janar 2019**, do të ofrojë gjashtë plane tarifore të reja me vlefshmëri mujore për pajtimtarët me paspagesë si më poshtë:

	Paketa 1	Paketa 2	Paketa 3
Pajtimi mujor (me TVSH)	1.300 Lekë	1.800 Lekë	2.600 Lekë
Internet	3GB	6GB	12GB
Minuta & SMS Kombëtare	2500&250	3500&350	4500&450
SMS brenda rrjetit Vodafone	2500	3500	4500
Minuta Ndërkombëtare	0	20	70

	Paketa 4	Paketa 5	Paketa 6
Pajtimi mujor (me TVSH)	1.500 Lekë	2.000 Lekë	3.000 Lekë
Internet	3GB	6GB	12GB
Minuta & SMS Kombëtare	2500&250	3500&350	4500&450
SMS brenda rrjetit Vodafone	2500	3500	4500
Minuta Ndërkombëtare	20	40	100

Paketat 1, 2 dhe 3 do të jenë të vlefshme për kategorinë e klientëve individ, ndërsa paketat 4, 5 dhe 6 do të jenë të vlefshme për kategorinë e klientëve biznes.

Klientët e rinj dhe ata ekzistues, të cilët do të rinovojnë kontratën e tyre në dyqanet Vodafone do të mund të përzgjedhin një nga planet tarifore të përmendura më sipër.

Për më shumë informacion, vizitoni dyqanet Vodafone ose kontaktoni Shërbimin e Klientit 140.



### Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

#### Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **30 Janar 2019**:

Paketa ditore standarde do të ndryshojë dhe do të ketë një çmim **150 Lekë** (me TVSH) duke ofruar **150 MB** internet, **150** minuta kombëtare, si dhe **150** SMS brenda rrjetit Vodafone të vlefshme për 24 orë.

Dy paketat javore standarde ekzistuese nuk do të ofrohen më në treg.

Një paketë e re javore standarde do të ofrohet në treg e cila do të ketë një çmim **500 Lekë** (me TVSH) dhe do të ofrojë **1GB** internet, **300** minuta kombëtare, **3.000** SMS brenda rrjetit Vodafone, si dhe **30** SMS kombëtare e vlefshme për 7 ditë.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall:

- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit.

**KËRKESA TË POSAÇME:**

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- b) Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- e) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**RISHPALLJE VENDI VAKANT**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

**"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun**

**KËRKESA TË POSAÇME:**

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët

e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



BOTIMI

# KOLEC TOPALLI

## Nga telat me gjemba, te fjalori etimologjik që e botoi me lekët e veta

Fatmira Nikolli

Fillimet e punës sime shken core kanë qenë të vështira. Babai ka qenë tregtar dhe vëllai i madh ishte arratisur ndaj familja ime ka qenë e persekutuar gjatë diktaturës komuniste. Babai dhe vëllai tjetër u dënuan me disa vite burg, ndërsa ne të tjerët u internuam. Unë kam qenë në moshën 10-vjeçare kur jam internuar në Berat, Tepelenë e Porto-Palermo. I liruam si i mitur pas një viti, mbarova shkollën e mesme pedagogjike dhe u emërova mësues. Për 36 vjet kam punuar në fshatrat e rretheve Kukës, Lezhë, Gramsh e Krujë dhe punën shkencore në albanologji e kam nisur vetëm në fillim të viteve '70, kur iu afrova Tiranës pas transferimit tim nga Gramshi në rrethin e Krujës".

Në një prej intervistave të fundit që dha para se të ndahej nga jeta, prof.Kolec Topalli e pat treguar kështu pikëtakimin e tij me albanologjinë. Në një interviste me Blerina Gocen, Topalli rrëfente se rruga që ndoqi në punën studimore ka qenë e lidhur me institucionet shkencore akademike, marrëdhëniet me të cilat kanë qenë të vështira e plot me pengesa. "Artikujt e botuar deri në vitet '90 kanë qenë të paktë dhe dy herë më së shpejtë ndërprerë e drejta e botimit. Por me demokracinë, kur u zhdukën pengesat e luftës së klasave, arrita të botoj nga një monografi në vit dhe shumë artikuj në revista shkencore brenda e jashtë vendi", thoshte profesori. Në mars të këtij viti, ai botoi "Fjalorin Etimologjik të shqipes", duke shënuar kurorëzimin e një punë dis-avjeçare.

"Fjalorin e kam botuar me kur-simet e mia. Për vepra të tilla me vlerë mbarekombëtare duhet të ndërhyjë shteti, pasi shpenzimet janë të konsiderueshme. Por shteti ndërhynte atëherë kur institucionet shkencore paraqesin vlerat e mëdha të një veprë dhe nevojën e shpenzimeve suplementare. Nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë mora përgjigjen 'S'kemi fonde'; kurse Qendra (Akademia) e Studimeve Albanologjike, pas një pritjeje të gjatë, më premtoi ta botoje me një tirazh minimal prej 500 kopje, edhe këtë pa caktuar afat. Kjo është arsyeja që vendosa ta botoj me shpenzimet e mia", shprehej ai.

### KUJTIMET

Në fund të jetës gjuhëtari i njohur Kolec Topalli shkroi kujtimet e veta. Ato janë përmbledhur në librin "Një jetë me brenga" dhe pas-



### "Një jetë me brenga", botohen pas vdekjes kujtimet e profesorit

qyrojnë gjithë çfarë gjuhëtari mbante mend; nga fëmijëria me vuajtje në kampet e internimit e deri te botimet studimet në shkencën e gjuhës. Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit i ka botuar ato në 80-vjetorin e lindjes së Topallit e pak muaj pasi ai u nda nga jeta. Drejtori i ISKK-së, Agron Tufa, si një prej atyre që e kanë nxitur Topallin të hidhte në

letër kujtimet, tha dje se "profesor Koleci nguronte t'i shkruante. Duke pasur një njohje të trajektoreve të jetës së tij personale, gjithmonë jam përpjekur që t'i ngjall interes në përshkrimin e jetës së vet. Për memuarët çdokush nguron, se u duket sikur me to çdo gjë është vulos psikologjikisht. Pas promovimit të fjalorit etimologjik të shqipes kemi bërë bisedën e fun-

dit dhe tha tani po dhe arriti. Një kuriozitet që më ka thënë ishte: fill pas mbarimit të rreshtit të fundit, të nesërmen më kishin ngrirë duart dhe nuk mund të shkruaja". Në një interviste për gazetaren Leontina Nika, Tufa rrëfen se libri ndalet në çdo etapë të jetës së Topallit. "Kaloi në kampet e njohura me telen dhe tjetra. Ka një moment kritik kur janë në Porto Palermo dhe asokohe 9 vjeç duke u endur mes jetës se vdekjes në spitalin e Himarës dhe kur kthehet nga spitali i dalin përpara Bardha Gjokmarkaj

dhe vajza të tjera që e marrin në krahë. E bija Xhoana Topalli ka fotografuar në tarracën e kalasë emrat, të gdhendura me gozhdë dhe aty është emri i vëllait të profesorit Ferdinand Topallit". Tufa thotë se thelbi i individualitetit të tij ka qenë gjithmonë optimizmi. "Ai me përvojën jetësore të hidhur u rrit me vështirësi dhe gjithmonë i ka tejkualuar në moshë të vogël. Renditje kronologjike e kujtimeve nga fëmijëria e hidhur deri tek triumfi i ngadaltë, deri tek ajo aureolë e ndritshme që e shoqëron në fushën e gjuhës. Megjithëse nuk ka mbajtur kurrë ditar libri vjen i shkruar në formë kronologjike. Këto kujtime në pikëpamjen e parë janë një dëshmi për brezat e rinj për të njohur më shumë nga e kaluara e hidhur komuniste rreth persekutimit të intelektualëve thekson Tufa. "Është një libër edukativ duke pasur parasysh edhe karakterin e dëshmuesit. Është rasti më fatlum se për vetë natyrën e atyre ata janë alergjikë ndaj ekzagjerimit dhe trillimit. Kemi mbi 100 faqe memuaristikë që i provon faktin e krahason dhe dëshmon atë që është e palëkundshme. Përcjell një të vërtetë të paekzagjuar të brezat". Libri pasqyron punën e një njeriu që punoi në heshtje dhe që arriti ta ndërtojë vetë fatin e tij, ku në fund të jetës arriti të përmbledhte përmes fjalorit etimologjik punën e tij kërkimore mbi 40-vjeçare.

Shkrimtari izraelit, Amos Oz është ndarë nga jeta dje në moshën 79-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë. Lajmi është konfirmuar nga e bija, Fania Oz-Salzberger. "Babai im vdiq nga kanceri pas një përkeqësimi të shpejtë që i ndodhi. Faleminderit për të gjithë ata që e deshën", ka shkruar ndër të tjera ajo në "Twitter". Veprat e Amos Oz janë botuar në 45 gjuhë në 47 vende të botës dhe ka marrë shumë nderime dhe çmime, mes të cilave Legjioni i Nderit të Francës, çmimi "Goethe", Çmimi i Princit të Asturisë në Letërsi, çmimi "Heinrich Heine" dhe Çmimi i Izraelit. Shpesh është i pranishëm në shtypin botëror me esetë dhe shkrimet e tij, veçanërisht mbi çështjen e konfliktit Izrael-Palestinë. Është autor i shumë vepra dhe mes tyre i: "Injëti det", "Kutia e zezë", "Majkëllim im", "Fima", "Në tokën e Izraelit", "Kundër fanatizmit" etj. "Rrëfim për dashurinë dhe errësirën" është një sagë familjare dhe një nga librat autobiografikë më të bukur të shkruar ndonjëherë në historinë e



letërsisë. Është historia e një fëmijë që rritet në një qytet të ndarë nga lufta, siç Jerusalemi i mesit të shekullit të kaluar, në një apartament të ngushtë, i mbytur përreth tij nga librat në gati dymbëdhjetë gjuhë dhe moria e po aq gjuhëve të folura nga njerëzit përreth tij, gjy-shërit, prindërit dhe të afërmit.

### SHUHET AMOS OZ, SHKRIMTARI I

#### "NJË RRËFIM PËR DASHURINË E ERRËSIRËN"

Është historia e një adoleshenti, jeta e të cilit ndryshoi pas vetëvrasjes së të ëmës kur ai ishte një fëmijë dymbëdhjetëvjeçar. Është historia e një burri, i cili jetoi mes kundërshtive të familjes dhe pigut të ëndrrave të tij, mes shkollave dhe pasuarëve të rrënuar, një burri të rritur në kibic, i cili ndërron mbiemrin e një burri që adhuron familjen, për të pohanur një aksiomë se "familja është institucioni më i mistershëm dhe më tërheqës në botë". Është historia e një shkrimtari që bëhet pjesëtar aktiv në jetën politike të atdheut të tij e që ndalet të rrëfejë këtë histori tronditëse. Dashuria dhe errësira janë dy burime të fuqishme energjie, që përshkohen këtë rrëfim të jashtëzakonshëm. Amos Oz merr një rrugëtim letrar nëpër fëmijëri dhe adoleshencën e tij, përmes rrugëve të Jerusalemit fatal, nëpër martesën e ferrit mes dy njerëzve krejt të ndryshëm, një babai nervoz dhe

të arsyeshem dhe një nëne romantike dhe ëndërrimtare. Gjahu mes këtyre dy botëve të ndryshme, është një djalë i vogël që do ta mbajë gjatë peshën e moshës në shpinë. Në rrëfimin e Oz parakalon jeta e një shekulli të tërë të familjes së tij, saga e dashuri-urrejtjes me Evropën, cinizmi i dashuri-urrejtjes me arabët. "Rrëfim për dashurinë dhe errësirën" është një libër tragjik, komik dhe pafundësisht transparent, një libër i shitur bujshëm dhe i lexuar me etje nga miliona lexues në të gjithë botën. Është autoportreti magjik i një shkrimtari, që jeta e shtyru të ishte dëshmtar i lindjes së një atdheu që ende jeton përmes historisë së tij të turbullt. Oz ishte një ndër shkrimtarët më të lexuar dhe më të njohur në Izrael. Vitet e fundit të tij, ai fliste haptas kundër politikës së kryeministrit izraelit Benjam Netanyahu.

# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 641

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi


E shtunë 29 Dhjetor 2018

## KARTOLINA E 2019-ës! Urimet më të veçanta të VIP-ave



Dikush dëshiron, fëmijë, dikush restorant, dikush njeriun e zemrës. Të rehat që na presin vitin që vjen

## E VËRTETË APO GENJESHTËR? Ja 'çiftet' dhe kandidatët për çift të 2019-ës



### "BIG BROTHER"

KURRË MË ? ARBANA OSMANI JEP LAJMIN E PAPRITUR PËR FANSAT



### PËRLOTET ARDIT GJEBRËA

"TI JE I TË GJITHËVE, NDËRSA UNË JAM KRENARË QË JAM VAJZA JOTE"



## Fitoi kupën për në Eurovizion, Jonida Maliqi merr vendimin e papritur!

Javën e kaluar këngëtarja Jonida Maliqi u shpall fituesja e festivalit të RTSH-së, e cila tashmë do të përfaqësojë Shqipërinë në Eurovizion me këngën "Ktheju tokës". E ftuar në emisionin e pasdites "Trokit" në "InTV", Jonida surprizoi me lajmin se gjatë pjesëmarrjes në Izrael për të përfaqësuar vendin tonë, kënga e saj nuk do të përkthehet në anglisht, por si rrallëherë do të këndohet në shqip, duke ruajtur identitetin e vendit. Gjithashtu, gjatë intervistës në studio këngëtarja u surprizua me një video-mesazh nga djemtë e "Eurovision Kosovo" dhe nga gazetari i famshëm nga "WiwiBlogs", William, të cilët e inkurajuan dhe i dhanë Jonidës këshilla për pjesëmarrjen në Eurovizion.



## "Ti je i të gjithëve, ndërsa unë jam krenare që jam vajza jote", përlotet Ardit Gjebrea nga fjalët e Anës

Ardit Gjebrea është surprizuar nga fëmijët e tij, Anna dhe Joni, që e bënë të përlotet. Në videon e publikuar nga promo i emisionit "Familja" nga Turjan Hysko, shohim Arditin teksa përlotet kur sheh Annën në zyrën e kryetarit të Bashkisë të Tiranës, Erion Veliaj. "Ti je Ardit i të gjithëve, ama unë jam Anna e Arditit dhe për këtë gjë jam shumë e lumtur", - i thotë ajo Arditit, i cili preket nga fjalët e saj dhe i mbushen sytë me lot. Më pas në video shohim sesi i afrohet djali i tij, Joni, i cili prej disa kohësh jeton jashtë vendit. Moderatorin Ardit Gjebrea e ka treguar gjithnjë që pika e tij do të ishte dhe njëkohësisht e fortë është familja e tij.

## Kurrë më "Big Brother"? Arbana Osmani jep lajmin e papritur për fansat

Arbana Osmani ka njoftuar përmes një postimi në llogarinë e saj të "Instagram"-it nisjen e programit "Dua të të bëj të lumtur". Mbi fotën e publikuar, moderatorja zbulon se këtë vit emisioni nis më 5 janar të 2019-ës. "E nisim vitin e ri bashkë!", - shkruan Arbana, e cila herë pas here ndan në rrjete sociale çaste nga përgatitjet dhe surprizat që priten në këtë edicion të "Dua të të bëj të lumtur". Gjithsesi, në një nga komentet dikush (dhe jo vetëm) pyetet për "Big Brother", si një nga "reality show"-t më të dashura për shqiptarët. "Po, 'Big Brother' kurrë fillon?", - shkruan një nga ndjekësit, i cili siç mund ta shihni në vend të "kur" shkruan "kurrë". Por duket, se lapsusi i fansit i doli në shteg për përgjigjen e moderatorës. "Mirë e the...", - përgjigjet Arbana dhe ndoshta po përpiqet të thotë që jo vetëm këtë vit, por edhe më tej, një format i tillë nuk do të shfaqet më në "Top Channel". Të jetë e vërtetë?




## Sa e ëmbël! Për herë të parë Ermal dhe Ami zbulojnë fytyrën e Sias

Së fundmi është publikuar një trailer i shkurtër i emisionit "Xing me Ermalin", përkatësisht puntata që do transmetohet mbrëmjen e sotme. Vetë moderatorin Ermal Mamaqi e ka cilësuar si emisionin më të veçantë që ka realizuar, pasi është i mbushur me shumë dashuri. Të gjithë presin surpriza të mëdha nga mbrëmja ku e ftuar speciale është bashkëshortja e Ermalit, Amarda Toska. Biseda duket se do të jetë argëtuese dhe shumë emocionuese. Detaje nga jeta e tyre familjare do të zbulohen në vazhdimësi, por më e bukura është zbuluar. Për herë të parë, çifti i njohur i "showbiz"-it na prezanton me Sian, të voglën e familjes, e cila erdhi në jetë 9 muaj më parë dhe deri më sot nuk e kishim parë asnjëherë si dukej. Prindërit duket se e kishin ruajtur shfaqjen e saj për këtë moment shumë special. Të qeshur dhe humori sigurisht që nuk do mungojnë, kështu që na mbetet vetëm të presim për ta parë programin në transmetim. Do jetë vërtetë i veçantë!



## Habit moderatorja shqiptare: Akoma besoj tek ti!

Të besuarit te Babagjyshi s'ka lidhje me moshën! Dhe këtë e ka vërtetuar edhe një nga moderatorët më të njohura shqiptare, e cila ka zbuluar se beson ende tek Babagjyshi. Klea Huta i ka shkruar edhe një letër atij, ku e falënderon ndërsa na tregon se ende ndihet fëmijë në shpirt aq sa të besojë ekzistencën e Babagjyshit: "Unë ende besoj tek ti. Ti ke lënë të paprekur fëmijën brenda meje. Më ke bërë të besoja që ekzistojë dhe ende të imagjinoj në një mal të lartë me dëborë, në një shtëpi të madhe, të ngrohtë, me drita, duke qeshur Ho-ho-ho. Faleminderit Santa!", shkruan Klea.



## Me zemra nga Nju Jorku, Andra dhe Sinani postojnë foton e veçantë për festa

Ata janë padyshim një prej çifteve më simpatike në "shoëbiz"-in shqiptar. Sinan Hoxha dhe Andra Destani aktualisht gjenden në Nju Jork për të kaluar këto ditë festash. Andra dhe Sinani kanë postuar një fotografi nga ky qytet madhështor, ku shihen duke u puthur. Ka qenë Andra, ajo e cila e ka postuar imazhin e shoqëruar me një emoji në formë zemre. Vërtetë një çift i veçantë!



## Zgjodhi Shqipërinë në vend të Italisë, Lorik Cana tregon arsyen e vërtetë

Ai është një ndër emrat e futbollistëve më të lakuar në media. Lorik Cana ishte i ftuar në emisionin "Opinion" si një ndër personazhet më të spikatur të këtij viti. Ai tregoi arsyen e vërtetë se përse la Italinë për të jetuar në Shqipëri. Loriku u shpreh se ai këtë vendim e kishte marrë për shkak se në Shqipëri është i angazhuar në fondacionin e bamirësisë, të cilin e ka krijuar vetë ai. Ai u shpreh se edhe pak muaj Shqipëria do të jetë vendbanimi i tij dhe shtoi se dëshiron të rikthehet në futboll, por si drejtues i një ekipi.



## Babai i fëmijës së pornostares? Flori flet për herë të parë për shtatzëninë

Vetëm pak muaj më parë, Flori Mumajesi u bë shkak i shkrimeve rozë, si shpeshherë. Mirëpo, këtë herë "u bë baba". Thuhej që Flori ishte prindi i fëmijës së pornostares Aby, e cila jeton në Amerikë. Edhe pse ajo nuk foli kurrë lidhur me shtatzëninë dhe kush është babai, Flori dha një shpjegim të shkurtër. I ftuar në "Opinion" tek Blendi Fevziu, Flori nuk i shpëtoi kësaj teme. 'Po i bone 'follow' dikujt, e hongre', tha artisti ndër të tjerash. Ja që nuk qenka e vërtetë.



## Vogëlushja e Rudinës mbush 2 vjeçe, aktorja prek me fjalët

Si çdo nënë, edhe për aktoren Rudina Dembacaj dita e ditëlindjes së fëmijës së saj është një nga më të lumturat. Vogëlushja e saj, Viktoria festoi 2-vjetorin e lindjes dhe ajo nuk mund të rezistonte pa i bërë një urim të ndjerë. "Sot, 2 vjeç e vogla ime! Nuk e harroj herën e parë kur të dëgjova zërin, kur të pashë fytyrën e të ndjeva aromën. Që atë ditë, ti je çlodhja e fryma ime. Të bekoftë Zoti bija ime! Unë 'vdes' për ty!", - përfundon Rudina krahas fotos së të voglës Viktoria. S'ka si fëmijët dhe këtë e shpreh qartë edhe Rudina!

Nga Alesia Bami e Albi Iskaj, te Xhilda Luzi e Rike Roçi, çfarë kërkuan të famshmit për Vitin e Ri

# VJEN KARTOLINA E 2019-ës!

## Ja urimet më të veçanta të VIP-ave

*Dikush dëshiron një fëmijë, dikush do të hapë një restorant, dikush njeriun e zemrës. Të rejat që na presin vitin që vjen*

**IGLI MEZINI**

"Gëzuar Vitin e Ri 2019! Uroj që ky vit t'ju mundësojë të ndiqni ëndrrat tuaja e t'i bëni ato realitet! Të arrini të gjeni lumturinë brenda vetes, të jeni në paqe me veten e me botën, të qeshni pafund, të falni e t'ju falin, të flisni e t'ju flasin, të ndihmoni e t'ju ndihmojnë e mbi të gjitha, qofshi të rrethuar nga njerëzit e zemrës! Mos harroni t'u bëni qejfin prindërve. Gjithçka do ishte më e bukur me bekimin e tyre. Gëzuar, gëzuar, gëzuar!"

**DONA PJETRI**

"Në radhë të parë, uroj që të jeni mirë me shëndet dhe të jeni falënderues për çdo ditë që marrim frymë. Uroj që ky vit i ri të jetë i destinuar për të plotësuar ëndrrat që nuk u bënë të mundura në 2018-ën. Shumë punë, shumë pozitivitet, shumë dashuri dhe çdo synim do jetë një sukses i garantuar. Ju përqaputh të gjithëve. Unë i kam vënë shumë synime jetës dhe do më duhet kohë që t'i bëj të gjitha, por mund të them që jam në rrugën e duhur dhe shpresoj 2019 të jetë një vit ku do më ngjitet më lartë me projektet e mija"

**INA ZHUPA**

"Uroj për gjithë shqiptarët sa më shumë mbarësi e begati në familjet e tyre, shëndet dhe ditë të lumtura! 2019 sjellte ndryshimin e madh! Një qeveri për shqiptarët dhe që 2018 të jetë viti i fundit që qeveria punon për një grusht njerëzish".

**SARA KOLAMI**

"Shëndet mbi të gjitha! Besoj se është një ndër gjërat më të rëndësishme që harrojmë! Të kujdesemi më shumë për veten edhe njerëzit që duam!"

**KLAUDIA KALIA**

Ky vit ka qenë mjaft i suksesshëm për mua, me shumë projekte si dhe me përfaqësimin e Shqipërisë në një ndër eventet më të mëdha botërore dhe duke qenë e para që e kam renditur Shqipërinë aq mirë. Për 2019 sigurisht që shpresoj të më realizohen planet për një karriere sa më të suksesshme, tashmë përsëri jashtë Shqipërisë. Por ajo ç'ka është më e rëndësishmja është që të kem familjen me shëndet

**Pamela Aliaj**

*Tashmë vetëm pak ditë na ndajnë nga ndërrimi i viteve dhe të gjithë, kush më pak e kush më shumë kthen kokën pas e sheh se sa shpejt 'rrëshqiti' edhe ky vit, ashtu si dhe gjithë të tjerët. Të gjithë kemi në zemër dëshira për një vit të ri më të mbarë dhe me pritshmëri më të mëdha se sa ato të vitit që jemi duke lënë pas. Të tilla dëshira i kanë edhe VIP-at tanë, të cilët kanë dhënë urimet e tyre ekskluzivisht për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare". Kush dëshiron fat e shumë mbarësi dhe kush dashuri të dhurojë më tepër për 2019-ën, por ka edhe nga ata që kanë plane serioze për vitin e ri, si për shembull të krijojnë një familje! Po ju e keni menduar urimin për 2019? Lexoni urimet e VIP-ave tanë, mbase e gjeni diku veten!*



**DONA PJETRI**



**SARA KOLAMI**



**XHILDA LUZI**



**IGLI MEZINI**



**STELA SALLAKU**

të mirë, sepse është gjëja më e shtrenjtë për mua! Dhe gjithashtu ju uroj të gjithëve një vit sa më të suksesshëm në atë çfarë dëshironi, por mbi të gjitha shëndetin dhe dashurinë!"

**STELA SALLAKU**

Dëshiroj që 2019-ta të jetë viti i fillimit të "Javës së Modës" edhe

këtu tek ne. Të jetë viti i plot gjërave pozitive, të bukura dhe plot të qeshura!"

**XHILDA LUZI**

"Çdo fillim viti na gjen me shpresën e një fillimi të ri! Më shumë se një fillim i ri, do doja që 2019 të shihnim si një mundësi fokusimi për një version më të mirë të vetes se

viti që lamë pas. Uroj të jetë një vit i mbarë, mbi të gjitha të kemi shëndet, shpresë, sukses dhe zemra të ngrohta pranë njerëzve që duam! Uroj sa më shumë bekime dhe dashuri në çdo familje! Gëzuar!"

**DONJETA KOSUMI**

"Të gjithë adhuroesve të mi

dhe njerëzve të mi të dashuri uroj një vit me shumë shëndet dhe mbarësi, harmoni me njëri-tjetrin! Për sa i përket jetës sime profesionale, do të sjell një projekt të ri në tregun muzikor, ndërsa në jetën private kërkoj ndoshta diçka më ndryshe. Një përkushtim për dikë që më kushton dashuri





ADEL LAMI



JONA KALEMAJ



ALFIO RROTANI



INA ZHUPA



DONJETA KOSUMI




NEVINA SHTYLLA



ALBI ISAKAJ



ALESIA BAMI



RIKE ROÇI



GERTA GIXHARI



KLAUDIA KALJA



VIVIAN CANAJ

2018! Qofshin të harruara çdo e keqe e vitit që shkoi dhe jetofshi vetëm ditë të lumtura!"

**ALFIO RROTANI**

"Urimi im është për të gjithë Shqipërinë që të gjithë të kenë më shumë të ardhura ekonomike, dashuri dhe lumturi në familjet e tyre! Dhe për vete do doja që 2019-ta të më sjellë sukses në karrierë për të gjitha planet që i kam vendosur vetes... si restoranti "Kripë dhe Piper" që po hap tani dhe shkolla e kuzhinës që do hapet në shtator".

**NEVINA SHTYLLA**

"Uroj të kenë shëndet e të ndihen sa më mirë me veten e tyre, se çdo gjë tjetër më pas vjen vetë. Gëzuar!"

**RIKE ROÇI**

"Urimi im është për një 2019 sa më të lumtur dhe me shëndet! Nga 2019 unë personalisht kërkoi vetëm pak fat dhe normalisht shëndeti gjëja parësore".

**ADEL LAMI**

"Personalisht, 2019 për mua do doja të më takonte me njeriun e zemrës. Përsa i përket urimit, uroj që çdokush ta ketë shpirtin plot!"

**GERTA GIXHARI**

"Uroj shumë që në 2019-ën shqiptarët të marrin në dorë fatin e të drejtave njerëzore për të jetuar pa stres në vendin tonë. Po aq e bukur sa duket Shqipëria virtualisht, ashtu edhe duam ta jetojmë. Pa abuzime, pa varfëri, me paga më të larta e çmime e taksa më të ulëta. Unë profesionalisht ndihem mirë dhe synoj akoma, por në kompleks problemet janë të shumta. Ato pak momente sadsifaksioni profesional apo me familjen, shuhen kur hyjnë gjithë këto faktorë që ndikojnë në formën e të jetuarit. Shqiptarë, mos sakrifikoni për mbijetesën, por i bëni rezistencë këtij sistemi për të jetuar mirë. Kërkoni!"

**VIVIAN CANAJ**

"Ju uroj të gjithëve një vit sa më të mbarë, të mbushur plot lumturi dhe dashuri. Do të doja të ndjeja një aromë pozitiviteti kudo. Shpresoj që njerëzit të motivohen në plotësimin e dëshirave të tyre në këtë vit të ri, pasi me vullnet dhe me dëshirën e mirë çdo gjë realizohet. Mua 2019-ta do të më gjegjë më të plotësuar se asnjëherë tjetër, gjithsesi edhe unë i kam ruajtur disa dëshira në sirtar, të cilat shpresoj të më realizohen këtë vit. Besoj se do të jetë një vit i mbarë!"

dhe anasjellas".

**ALESIA BAMI**

"Gëzuar Vitin e Ri të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen! Shëndet e mbarësi në çdo familje. Qoftë ky një vit i mbarë. Nga 2019 do doja që të sillte ndryshim për çdo familje në nevojë. Qofshin më të pakta raste të tilla. Gëzuar!"

**ALBI ISAKAJ**

"Sa më shumë mirënjohje, dashuri dhe njerëz që të na bëjnë të lumtur, se 2018-ta na e piu lëngun!" (qesh)

**JONA KALEMAJ**

"Këto urimet e festave janë me të njëjtat fjalë si çdo vit në fakt. Mbjaj mend që e vogël, të njëjtat

urime bëheshin çdo vit. Dikur fjalët i shkruanim në kartolina e tani nëpër rrjete sociale. Dhe pse urojme me shpirt që të jetë një vit i bekuar ky i riu, do ketë gjemba gjatë vitit që do të lëndojnë. 2018 për mua ka qenë shumë i qetë në fakt dhe e mbylla me dhuratën e Zotit, ardhjen në jetë të vajzës së

dytë! Këtë kërkoi edhe nga 2019! Që të jetë po kaq e qetë (por jo me beb tjetër hë për hë - qesh) dhe i pastë gjemba sa me të vegjëll ky vit për të gjithë. Jetojeni dhe shtojni këtij viti edhe një dozë më shumë dashuri, gëzime, sinqeritet, buzëqeshje, sepse jam e sigurt që do e shijoni më shumë se

U lidhën apo s'kanë vendosur ta bëjnë publike? Cilët janë VIP-at që 'fshehën' të dashurit

# E VËRTETË APO GËNJESHTËR?

## Ja 'çiftet' dhe kandidatët për çift të 2019-ës

*Nga Luana Vjollca te Seldi Qalliu, kush u fejua, u nda e u lidh sërish në 2018-ën*

### FLOR MUMAJESI DHE KEJSI TOLA

Pas përfundimit të festivalit "Kënga Magjike", të gjithë shikuesit kanë një pyetje të madhe që po i bren nga brenda "A është Flori Mumajesi dhe Kejsi Tola, çifti më i ri i 'showbiz'-it?" Fillimisht, Kejsi Tola nuk pushonte me falënderimet për kompozitorin e këngës, pra për Flori Mumajesin. Në "E diela Shqiptare" të dielën e shkuar, teksa shprehte vlerësimin ndaj tij, Flori u përgjigj: "S'ka problem, më ke mua". Të gjithë mbetëm pa fjalë, kur Flori nuk e la vetëm dhe vrapoi drejt saj të vallëzonte në skenën e "E diela Shqiptare". Vështrimet që ata i hidhnin njëri-tjetrit gjatë vallëzimit dukeshin aq të ngrohta si të ishin të dashuruar. Nuk mbaron me kaq, këngëtari publikoi foton ku kapeshin dy duart e tyre, ndërsa lart shkruhej një pjesë e tekstit të këngës. Në darkën e artistëve të "Kënga Magjike", Kejsi qëndronte e ulur pranë Florit. Rastësi, apo vërtetë ka diçka mes tyre? Gjuha e trupit nuk gënjën!

### MC KRESHA DHE EVI REÇI

Lajmi se Mc Kresha dhe Evi Reçi janë në lidhje i ka habitur të gjithë. Së fundmi ka qarkulluar një lajm se Mc Kresha dhe Evi Reçi janë në lidhje prej dy vitesh. Mirëpo kjo gjë po del të jetë e pavërtetë, pasi në një prononcim për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" Evi Reçi e ka mohuar kategorikisht një gjë të tillë. "Si unë dhe ai kemi dhënë deklaratë që nuk është aspak e vërtetë! Janë aludime portalesh. Jemi miq, kemi respekt maksimal për njëri-tjetrin dhe kaq!", ka qenë përgjigja e këngëtares. Ja dhe një tjetër aludim i hedhur poshtë. Njëherë i lidhur me Finin e tani me Evin? E kujt është radha tani për "t'u lidhur" Kresha?

### SELDI QALLIU DHE KEJSI MEDINI


Seldi Qalliu ka tre muaj që është ndarë nga e fejuara e tij, këngëtarja Mimoza Shkodra. Ndonëse bashkëjetonte me Mimosën në Zvicër, tani këngëtari është kthyer në Shqipëri, ku dhe po merr pjesë

Pamela Aliaj

*Kush u nda e kush u bashkua? Ky vit ishte vërtet i lodhshëm dhe i ngarkuar për të 'ndjekur' nga pas ata VIP-a që donin medoemos të fshihnin lidhjet e tyre. Është e vërtetë që tashmë jeta private është bërë e shtrenjtë dhe me çmim për më tepër! Por, me ato që janë thënë lartë e poshtë si dhe me mohimet që shumica prej tyre kanë bërë për të mos pranuar aludime të tilla, na ka sjellë një pikëpyetje të madhe, e cila mbase sqarohet në vitin 2019. Kush po e kush jo, më poshtë ju paraqesim "çiftet" dhe ata që vërtetë e pranuan lidhjen e tyre për këtë vit që po përfundon.*



Flor Mumajesi & Kejsi Tola



Alfio & Fatma

në spektaklin "Dance With Me". Javë më parë ai u përfol në media për shoqërimin me vajzën e këngëtarit shqiptar Sabian Medinit, Kejsi. Ai dhe

Kejsi janë parë sërish bashkë në një event në Shqipëri, ku është Kejsi ajo që ka publikuar një video ku shihet bashkë me Seldin. Më në fund

Seldi ka zbuluar për të gjithë fansat e tij me postimit e një fotografie në "Instagram", për projektin e tij ku shfaqet me një biondinë mjaft seksi... Pro-

jektit i tij titullohet "S'ka dashni", por siç shihet nga postimi i Seldit, projektin do ta sjellë edhe me videoklip, pjesë e së cilës do të jetë një



Seldi Qalliu & Kejsi Medini



Luana dhe Krenari




Kida & Uki



Fero & Arbenita



Mc Kresha & Evi Reçi



biondinë joshëse. Ai e ka shkruar në postimin e tij "S'ka dashni", shumë shpejt". Të jenë çift së bashku vallë? Disa komente të tij në fotot e Kejsit na bëjnë të dyshojmë.

**FERO DHE ARBENITA**

Ditë më parë u spekulla për një lidhje të mundshme në mes të reperit Fero dhe modeles së njohur Arbenita Ismajli. Këto dyshime erdhën pas disa komenteve që reperi i kishte bërë në fotografitë e modeles. Tani gjërat mes dyshes duket se janë konfirmuar. Ata janë fotografuar në të njëjtin vend, pranë një ndërtese në Frankfurt. Fero dhe modelia Arbenita nuk kanë postuar imazhe të përbashkëta, por fotografitë e publikuara në të njëjtën kohë duket se janë të qëllimshme dhe ka ngritur dyshimet edhe më shumë. Sa të ëmbël që duken bashkë!

**KIDA DHE UKI**

Uki dhe Kida nuk janë më as miq. Këngëtari Uki Latifi dhe Kida dikur ishin të lidhur aq shumë sa që gjithë menduan se ka diçka më shumë mes kësaj dyshjeje të njohur. Por, siç shihet ata sot nuk flasin me njëri-tjetrin, pasi edhe në rrjetet sociale nuk ndiqen, duke mos dhënë ndonjë arsye për këtë ndryshim raportit. Sa keq! Do të ishin vërtet një çift shumë i veçantë!

**ALFIO DHE FATMA**

Moderatorja Fatma Methasani dhe shefi i kuzhinës Alfio Rrotani kanë tërhequr vëmendjen e të gjithëve së fundmi me historinë e veçantë të dashurisë, të cilën e mbajtën të fshehtë nga syri i publikut për dy vite. Gjithçka mes tyre nisi në studiot e televizionit "InTV", ku punonin së bashku, por në

emisione të ndryshme. Pëlqimin dhe romancën e lindur mes tyre që në takimin e parë çifti i ka treguar në një intervistë për revista "Class". "Ishte koha kur, gjatë fazës së pushimeve, të gjithë moderatorët duhet të bënin një fushatë publicitare. Alfio ndërkohe kishte një vit që punonte në televizion me një projekt të jashtëm, 'InLife', xhirimet e të cilit bëheshin në një vilë nga kalaja e Petrelës. Aty u takuam për herë të parë", - tregon Fatma. "Kam parë ca detaje që më bënë përshtypje, atë fjonon kështu, ajo luoja në kokë... Nuk e harroj dot ndjesinë që pata kur e pashë për herë të parë", - rrëfen Alfio, duke lënë të kuptohet se i kanë lindur ndjenja për Fatmën që në momentin e parë që janë ndeshur së bashku. Një nga çiftet më të veçanta të këtij viti!

**LUANA DHE KRENARI**

Luana Vjollca dhe Krenar Çoçaj janë një prej çifteve më të komentuar të "showbiz"-it shqiptar, të cilët megjithëse janë kapur shpesh mat në shoqërinë e njëri-tjetrit, kanë preferuar të mos e pranojnë publikisht marrëdhënien e tyre. Disa javë më parë çifti u përfol për ndarje, pasi nuk e ndiqnin më njëri-tjetrin në rrjetin social "Instagram" dhe u aludua se marrëdhënia e tyre e dashurisë kishte marrë fund. Mirëpo, mbrëmjen e kaluar ata janë kapur mat nga "Prive", teksa kremonin së bashku Krishtlindjet. Luana dhe Krenari janë fotografuar në Katedralen Shën Nënë Tereza në Prishtinë, ku moderatorja kishte shkuar për të qenë pranë partnerit të saj. U kapën më në fund e s'kanë ku të shpëtojnë!

Dje në "Deutsche Welle"

# Shqipëria dhe nami si Kolumbia e Europës

Nga Thomas Brey

(vijon nga faqja 1)

... dhe Maqedonia arritën si vende kandidatë që Brukseli në qershor të vitit të ardhshëm të hapë negociatat e anëtarësimit. Por se si do të jenë forcat politike në Parlamentin Europian pas zgjedhjeve europiane, e nëse do të ketë një shumicë për të hapur negociatat, kjo nuk dihet.

## BOSNJA

Me gjithë miliardat e BE-së, një ushtri të tërë diplomatësh dhe ekspertësh, Bosnje-Hercegovina ofron imazhin e një shteti të dështuar. Për shkak se katolikët kroatë, 15% e popullsisë, ndjehen se janë mënjanuar në zgjedhjet e kaluara, ata bëjnë pakt me serbët ortodoksë të Milorad Dodikut. Ai kërkon ta ndajë që sot pjesën serbe, me rreth 1 milion banorë nga Bosnje-Hercegovina dhe t'i bashkohet "republikës mëmë", Serbisë. Kjo bën që të mos dihet se kur do të përfundojë krijimi i qeverisë, sepse nuk mund të funksionojë një pakt i tillë kundër vullnetit të myslimanëve boshnjakë, që përbëjnë me rezultat të ngushtë shumicën e popullsisë.

## MAQEDONIA

Me pikëpyetje është po ashtu, nëse Maqedonia deri në atë kohë do të mund të ketë zgjidhur grindjen dhjetërvjeçare me Greqinë për çështjen e emrit dhe të ketë marrë emrin e ri "Maqedonia Veriore". Në parlamentin grek, një shumicë për këtë është edhe më e pasigurt se në parlamentin maqedonas.

## KOSOVA

Por më keq gjendja paraqitet në Kosovë. Qeveria dhe opozita bllokohen në parlament njëra-tjetrën, duke sjellë një gjendje të paralizës politike. Misioni më i madh i BE për drejtësinë, EULEX pas 10 vjetësh dhe disa aferash korrupsioni brenda radhëve të veta duket sikur është dorëzuar. Popullsia shqiptare në shumicë, përkundër vullnetit të BE-së e dha sinjalin për krijimin e një ushtrie të vetën dhe vendosi 100% dogana ndëshkuese për mallrat nga fqinji i padashur, Serbia. Dialogu i pasuksesshëm Kosovë-Serbi, i ndërmetësuar nga BE prej vitesh, tani më është ndërprerë.

## SHQIPËRIA

Shqipëria, që i ka dalë nami si "Kolumbia e Europës", ende nuk shënon suksese të ndjeshme dhe të qëndrueshme në luftën kundër kultivimit të drogës. Edhe reformat politike, si ristrukturimi i drejtësisë kanë ecur ngadalë.

## MALI I ZI

Në Malin e Zi negociatat e anëtarësimit nuk kanë ndryshuar asgjë në atë që Milo Djukanoviç që në maj u zgjodh president i vendit, përkundër të gjitha rregullave



demokratike mbetet në këtë minishtet etaloni i të gjitha gjërave. Ai sundon prej 27 vjetësh e ndjehet ndërkohë kaq i fuqishëm, saqë në fund të nëntorit lejoi arrestimin e kreut të opozitës, Nebojsa Medojeviç, megjithëse ai zotëron imunitet si anëtar i parlamentit.

## SERBIA

Në Serbi njeriu i fortë që sundon në vend e gjithçka është presidenti, Aleksandar Vuçiç. Ai kontrollon parlamentin dhe drejtësinë, si mediat dhe policinë.

## PSE NDIKON KAQ PAK POLITIKA E BE-SË NË BALLKAN?

"Cili është shkak i dështimit të deritanishëm të BE-së në Ball-

kan", pyet ekspertja Gudrun Steinacker. Ajo ka qenë ambasadore në Shkup dhe Podgoricë dhe konsiderohet një njohëse më të mira të rajonit. Për herë të parë ka folur dikush nga qarqet e brendshme për deficitet e politikës së Ballkanit.

Steinacker kritikon veçanërisht strategjinë e re të BE-së për Ballkanin Perëndimor të paraqitur në shkurt të këtij viti. Aty "gjenden analiza, por jo receta të reja", thotë ajo. Nga ana tjetër reflektohet shumë pak "në mënyrë vetëkritike se çfarë ka ndodhur dhe çfarë duhet bërë". Gudrun Steinacker shikon një gabim sistematik të BE-së në Ballkan. Përgjegjësi bëhet zbatues, sipas saj. "Të njëjtat qeveri, në masë të madhe me të njëjtët politikanë, që janë përgjegjës për gjendjen kritike do duhet tani të rregullojnë punën".

Edhe ekspertët të tjerë në Ballkan arrijnë në të njëjtat përfundime. Ekonomisti amerikan me origjinë nga Beogradi, Branko Milanoviç, drejtori i degës boshnjake të "Transparency International", Srdjan Blagovcajn e të

tjerë theksojnë se në sistemet politike të 6 vendeve të Ballkanit bëhet fjalë për gjoja-demokraci, ku përmes manipulimeve masive, në krye del gjithmonë vetëm një parti.

Nga ana tjetër, parti jodemokratike të prera për kryetarin e tyre e sigurojnë pushtetin përmes një sistemi klientelist. Në qendër të politikës nuk janë programe liberale dhe ideologji, në qendër është vjedhja dhe synimi që të mirat e siguruar ta shpërndahen tek klanet e mbështetësve.

Ekspertët perëndimorë dhe vendës janë të mendimit se kjo gjendje e vështirë mund të përmirësohet vetëm me tërheqjen e shoqërisë civile, mediave dhe organizatave jofitimprurëse. Sepse politikanët e gjithëpushtetshëm do të bëjnë gjithçka për të ruajtur monopolin e pushtetit. Si pasojë, BE-së ata i provojnë se kanë vullnetin për gjoja reforma. Por rregulloret e ligjet më të mira nuk kanë asnjë efekt, nëse nuk praktikohen. Në të vërtetë bëhet gjithçka në Ballkan për të penguar modernizimin dhe progresin ashtu siç kuptohet në BE. Sepse një gjë e kanë të qartë të pushtetshmit në Ballkan: nëse normat e BE vërtet vihen në jetë, ata e kanë të humbur pozitën.

Opinion *i* Ditës

# Koha për ndryshim në gjyqësorin shqiptar, një vështrimin pas një viti të procesit të vetingut

Nga Genoveva Ruiz Calavera

*Drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian dhe shefe e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).*

(vijon nga faqja 1)

... në Shqipëri, që duhen shënjuar teksta i afrohem fundit të vitit. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët shqyrtojnë rastet e vetingut në shkallë të parë, kanë arritur vendimin e tyre thuajse të 100-të në më pak se një vit që nga seanca e parë e vetingut. Në të njëjtën kohë janë hedhur bazat për institucionet e reja, që do të garantojnë vetëqeverisjen e pavarur të gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë sapo kanë mbajtur seancat e tyre përkatëse konstitutive. Këto arritje pasuan muaj pune dhe sfidash të mëdha, disa prej të cilave në momente të caktuara dukeshin të vështira për t'u kapërcyer.

Secili prej rreth 800 gjykatësve dhe prokurorëve në të gjithë vendin po i nënshtrohet një hetimi mbi integritetin, precedentet penalë dhe kompetencën profesionale. Nga të gjitha rastet e trajtuara deri më tani, pothuajse gjysma kanë rezultuar me shkarkimin ose dorëheqjen vullnetare të atyre që janë vlerësuar Komisioni Evropian ndihet shumë i inkurajuar kur mëson nga magjiistratë e BE-së dhe SHBA-ve, të cilët po e mbikëqyrin këtë proces si pjesë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, se hetimet e vetingut po kryhen në mënyrë të plotë dhe profesionale. Ndërsa shumica e apelimeve janë në pritje, mund të shihet se ky proces ka nisur tashmë të japë rezultate.

Kjo ndërmarrje monumentale



dhe numri i madh i shkarkimeve çoi në shtyrjen e formimit të institucioneve të reja gjyqësore dhe ndikoi në funksionimin e institucioneve gjyqësore. Por, sado problematike që janë, kufizimet e përkohshme në funksionimin e sistemit të drejtësisë, të cilat madje kanë rezultuar me humbjen e kuorumit në Gjykatën Kushtetuese, janë të pashmangshme për të ndërtuar një gjyqësor, të cilin qytetarët shqiptarë mund t'i besojnë për të respektuar shtetin e së drejtës mbi gjithçka tjetër.

Tani që është formuar Këshilli i ri për Emërimet në Drejtësi, së bashku me Këshillin e Lartë të

Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë i Gjyqësor të ndarë, një thirrje u drejtohet të gjithë anëtarëve të sapoemëruar për të përbushur më së miri detyrën e tyre, e cila siguron që gjyqësori mund të funksionojë në mënyrë të pavarur, i lirë nga çdo ndikim apo trysni e panevojshme nga politika apo nga çdo forcë tjetër e jashtme. Është gjithashtu e rëndësishme që të gjitha autoritetet përgjegjëse për emërimin e anëtarëve në Gjykatën Kushtetuese t'i ushtrojnë detyrat e tyre në kohën e duhur dhe në mënyrë profesionale.

Zhvillimet e fundit tregojnë se reforma po jep rezultate dhe se

Shqipëria është në rrugë të mbarë drejt krijimit të një sistemi drejtësie pa paafësi, njëanshmëri dhe korrupsion.

Viti i kaluar dëshmoi fillimin e një procesi, që do të kërkojë kohë dhe vetë vetingu është vetëm një pjesë e vogël e reformës së gjyqësorit dhe e transformimit të përgjithshëm, të cilin Shqipëria do të vazhdojë t'i nënshtrohet në të ardhmen për konsolidimin e shtetit të së drejtës. Kjo është ajo që dëshirojnë dhe meritojnë qytetarët e Shqipërisë, prandaj Bashkimi Evropian do të vazhdojë t'i shoqërojë institucionet e Shqipërisë në këtë përpjekje historike.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Personat e kësaj shenje nuk rekomandohet të mendojnë rreth asaj çfarë i pret nesër. Në prag të Vitit të Ri duhet të shmangni dyshimet, frikën apo shqetësimet rreth çështjeve të caktuara. Përpiquni ta kaloni sa më bukur festën e fundvitit dhe mendoni rreth pushimeve që mund të realizoni.

**DEMI**  
Demat sot mund të marrin një telefonatë të papritur. Ka gjasë t'ju vijë një ofertë në lidhje e punën. Mos u nxitoni të jepni përgjigje menjëherë. Ju duhet patjetër kohë për të kuptuar situatën. Mund të kenë surpriza edhe në jetën personale.

**BINJAKET**  
Bëni shumë kujdes me sjelljen sot. Mobjini në pesimizëm dhe përpiquni të mendoni pozitivisht. Mos u fokusoni vetëm te vetja, por mendoni sesi të ndihmoni edhe njerëzit në nevojë. Në mbrembje do të kaloni momente shumë të veçanta me partnerin/partneren tuaj.

**GAFORJA**  
Gaforret nuk duhet t'u besojnë të huajve sot. Propabiliteti për takime të papritura, ku do të ndërthuren interesat personale me ato profesionale do të rritet. Ka gjasë t'ju takojë një person, i cili do t'ju japë një premim shumë të fortë. Megjithatë, mos e besoni menjëherë pa e shqyrtuar mirë situatën.

**LUANI**  
Disa persona të kësaj shenje do t'i lënë nën hije të gjithë personat e mbledhur në një event. Kjo mund të ndodhë ose në festën e punës, ose në një jetësh event me miq të ngushtë. Sa i përket anës romantike, do të pësoni disa ndryshime thelbësore.

**VIRGJERESHA**  
Sot do të keni fatin të takoheni me një person të jashtëzakonshëm, me të cilin mund të krijoni një lidhje shumë të fortë ose shoqërore ose dashurie. Bëni kujdes me financat në mbrembje. Një shpenzim i papritur mund t'ju shkaktojë probleme të mëdha.

**PESHORJA**  
Sot peshoret do të kenë shumë dëshirë të komunikojnë. Gjatë takimeve apo bisedave telefonike përzgjidhni fjalët dhe bëni shumë kujdes me ato që thoni, pasi dikush mund të ofendohet. Është dita e duhur për të bërë shopping.

**AKREPI**  
Gjatë ditës së sotme do të ndiheni optimist, por do ta kaloni cahun duke dalë jashtë realitetit. Do të humbini një rast shumë të veçantë, i cili mund t'ju rriste profesionalisht. Rrezikoni të gaboni, ndaj duhet të jeni shumë të kujdesshëm.

**SHIGJETARI**  
Dotë përfundoni të gjitha punët e lëna përgjysmë për vitin 2018. Gjithashtu, do të keni mundësi për t'u raktuar dhe për të shpenzuar kohë pranë miqve tuaj të ngushtë. Sa i përket anës romantike, do të zhviloni një bisedë shumë të rëndësishme me partnerin/partneren tuaj.

**BRICJAPI**  
Bricjapët mund të 'pushtohen' nga sharmi i dikujt. Do të takoheni rastësisht dhe nuk ka gjasë të takoheni herë tjetër. Do të ndiheni shumë mirë në punë dhe nuk do të ndjeni aspak stres.

**UJORI**  
Do të shënoni sukses në disa çështje të caktuara. Megjithatë, sot mund të përballeni me një situatë të vështirë, por përpiquni të mos përfshihen nga paniku, pasi nuk do të mund të zgjidhni asgjë.

**PESHQIT**  
Peshqit do të kalojnë një ditë mjaft të mirë në punë. Nuk do të lodheni, por vetëm do të ndjeni kënaqësi. Kjo do të vijë falë kartolinave dhe dhuratave që do të shkëmbeni me kolegët për Vitin e Ri. Gjithashtu, edhe mbrembja do të jetë mjaft premtuese për ju.

MERKATOJA E KUQE



Partizani firmos me Jusufin, synon Idrizajin

Partizani ka nisur merkaton e janarit dhe menjëherë është vënë në lëvizje për repartin e avancuar. Nga Maqedonia, aty ku një vit më parë mori Jasir Asanin, synohet që të bëhet edhe një tjetër goditje si ajo e Asanit. Lojtari i afruar së fundmi kampin e

kuq, është sulmuesi i krahut Fatjon Jusufi, i cili për shumë vite ka qenë një pjesë e rëndësishme e skuadrës tetovare të Renovës. Jusufi që luan në të dyja krahët e sulmit, mund të jetë një armë shtesë për Skënder Gegën, duke ditur se kampionati është i gjatë dhe

në çdo moment mund të jetë një lojtar i nevojshëm për të kuqtë. Aktualisht në dy krahët e sulmit aktivizohen Mala dhe Asani, ndërkohë që me afrimin e Jusufit pritet që Gega të jetë më i qetë edhe në rast se ndonjëri prej tyre mund të mungojë në ndeshje

të caktuara. Prezantimi i tij pritet të bëhet ditët në vijim, ndërkohë që pritet të ketë edhe të tjera lëvizje. Ndërkohë vijnë bisedimet me Hektor Idrizajn e Kamzës, që pritet të jetë një alternativë më shumë në krahun e majtë të mbrojtjes së kuqe.

Tekniku është në dilemë, nëse do të vazhdojë me bardhezinjtë, apo do të transferohet te Junajtid

Alegri: Ndeshjet s'duhën ndërprerë, të ardhmen time e vendos në qershor

Trajneri i Juventusit sulmon ashpër racizmin

Jeton Selimi

Trajneri i Juventusit, Masimiliano Alegri ka folur për mediat italiane, ku ka prekur disa tema. Numri 1 i bardhezinjve ka folur për cilësinë e futbollit italian, ndalimin e ndeshjeve për shkak të racizmit dhe për të ardhmen e tij, ku flitet për një transferim të Manchester Junajtid, me anglezët që kanë larguar Zhoze Murinjonin dhe ia kanë besuar stolin përkohësisht ish-sulmuesit norvegjez, Ole Gunar Solskjaer. Por më parë, Alegri duhet të mbyllë kampionatin me Juventusin, teksa duket se këtë vit hendeku me ndjekësit është edhe më i madh.

FUTBOLLI ITALIAN

"Ne kemi një tjetër mundësi për të ndryshuar gjërat. Biseda nuk është e nevojshme, ne duhet të bëjmë gjëra, por nuk varet nga unë, Anceloti apo Gatzoga.

NDALIMI I NDESHJEVE

"Unë nuk menjoh se është e drejtë. Autoritetet publike janë përgjegjëse për këtë dhe jo për ne. Duhet parandaluar çdo lloj racizmi dhe diskriminimi. Kur thuhet që duhen masa, nuk duhet thënë veç me fjalë, por edhe të vihen në zbatim. Nuk e di nëse është mirë të mbyllem stadiumet. Sigurisht që nuk i zgjidh



problemet tona, është një zgjidhje e përkohshme. Problemi duhet të zgjidhet rrënjësisht e jo përkohësisht".

KAMPIONATI AKTUAL

"Në kampionat kemi 50 pikë dhe nuk mund të thuhet që janë pak. Kemi fituar 16 ndeshje dhe jemi renditur

në vendin e parë në Ligën e Kampionëve. Tanio duhet të shohim nga ndeshjet e radhës dhe ta mbyllem vitin me 53 pikë", tha mes të tjerash Alegri.

BARDHMJA BARDHEZI

"Kam kontratë me Juven-

tusin dhe jam i lumtur këtu. Ne jemi duke bërë një punë të shkëlqyer së bashku me klubin. Ka shumë ndeshje për të fituar para fundit të sezonit, ka kohë deri në qershor. Unë dua të qëndroj për të përmirësuar futbollin italian", - tha Alegri.

Premtimi i veçantë

Ferrero: Po munda Juven, do i qeth flokët si Naingolan

Sampdoria ka këtë javë një takim mjaft të vështirë në transfertë ndaj Juventusit. Në prag të këtij takimi, për mediat ka folur presidenti i Sampdorias, Masimo Ferrero, i cili tashmë njihet për tipin e tij të veçantë. Ai është i bindur se skuadra e tij do ta ketë të vështirë ndaj Juventusit dhe madje, ka bërë një premtim mjaft të çuditshëm. "Unë jam një njeri me shumë flokë dhe kam qenë gjithmonë me flokë të gjatë, por nëse fitojmë ndaj Juventusit, do t'i pres të gjitha. Do t'i bëj flokët si Naingolan. Inter-Napoli? Unë nuk dua të keqkuptohem, por futboli është një shfaqje dhe shfaqjet kurrë nuk ndalen. Duhet bërë stadiume me sigurisë më të lartë dhe nëse një ultras nuk sillet ashtu siç duhet, mund t'i ndalohej hyrja në stadium. Racizmi nuk duhet të ekzistojë dhe njerëzit duhet të arrestohen", u shpreh Ferrero.



TRAJNERI I BAVAREZËVE

Kovaç: Bajerni, shumë shpejt në krye të tabelës

Trajneri i Bajernit të Mynihut, Niko Kovaç ka folur për mediat gjermane, ku ka diskutuar për çështjen e titullit kampion. Vitet e fundit, Bajerni ka dominuar në Bundesligë, por ky sezon duket i vështirë për bavarezët, duke parë edhe formën fantastike që po kalon Dortmundi. Aktualisht, Bajerni është 6 pikë larg verdhezinjve, që kryesojnë renditjen prej shumë javësh tashmë. Por Kovaç u shpreh i bindur se Bajerni i tij do e parakalojë shumë shpejt në renditje Dortmundin dhe do të jenë ata dhe njëherë tjetër skuadra kampione. "Ka qenë një gjysmësezonë me shumë ulje-ngritje, por ne jemi Bajerni i Mynihut dhe shumë shpejt do të rikthehemi aty ku na takon. Brenda pak kohësh do të parakalojmë rivalët dhe do të jemi në krye të tabelës. Në gjysmën e dytë të sezonit do të shihni Bajernin që jeni



trajneri i Bayernit të Mynihut, Niko Kovaç ka folur për mediat gjermane, ku ka diskutuar për çështjen e titullit kampion. Vitet e fundit, Bajerni ka dominuar në Bundesligë, por ky sezon duket i vështirë për bavarezët, duke parë edhe formën fantastike që po kalon Dortmundi. Aktualisht, Bajerni është 6 pikë larg verdhezinjve, që kryesojnë renditjen prej shumë javësh tashmë. Por Kovaç u shpreh i bindur se Bajerni i tij do e parakalojë shumë shpejt në renditje Dortmundin dhe do të jenë ata dhe njëherë tjetër skuadra kampione. "Ka qenë një gjysmësezonë me shumë ulje-ngritje, por ne jemi Bajerni i Mynihut dhe shumë shpejt do të rikthehemi aty ku na takon. Brenda pak kohësh do të parakalojmë rivalët dhe do të jemi në krye të tabelës. Në gjysmën e dytë të sezonit do të shihni Bajernin që jeni

PREFEKTI I MILANOS

Sakone: Në janar, samit sigurie për futbollin

Ekipet e Serie A zbresin nesër në fushë për herë të fundit në këtë vit, ndërsa të gjithë po merren me racizmin dhe urrejtjen e madhe që ka përfshirë futbollin italian. Koret diskriminuese ndaj Kalidu Kuliabli, mbrojtësit senegalez të Napolit dhe vdekja e një tifozit i interesit i kanë vënë një njiollë të madhe futbollit italian dhe ndërhyrja është e nevojshme. I fundit që ka folur ka qenë Renato Sakone, prefekti i Milanos. Ai ka paralajmëruar një mbledhje sigurie, ku do të marrin pjesë edhe dy klubet e Milanos për t'i dhënë fund kësaj historie. Duhet dënuar individët e dhunshëm dhe duhet evituar dënimi i tifozëve të pastër dhe të pafajshëm. "Ndeshja e radhës në të cilën Interi do të luajë me stadiumin plot është në mesin e shkurtit. Në janar do të bëjmë një samit të sigurisë, që do të përfshijë klubet e Interit dhe Milanit. Qëllimi është izolimi i dhunuesve. Nuk mund të paguajmë të gjithë tifozët për sjelljet kriminale të disave", përfundon Renato Sakone, prefekti i Milanos.




Ekipet e Serie A zbresin nesër në fushë për herë të fundit në këtë vit, ndërsa të gjithë po merren me racizmin dhe urrejtjen e madhe që ka përfshirë futbollin italian. Koret diskriminuese ndaj Kalidu Kuliabli, mbrojtësit senegalez të Napolit dhe vdekja e një tifozit i interesit i kanë vënë një njiollë të madhe futbollit italian dhe ndërhyrja është e nevojshme. I fundit që ka folur ka qenë Renato Sakone, prefekti i Milanos. Ai ka paralajmëruar një mbledhje sigurie, ku do të marrin pjesë edhe dy klubet e Milanos për t'i dhënë fund kësaj historie. Duhet dënuar individët e dhunshëm dhe duhet evituar dënimi i tifozëve të pastër dhe të pafajshëm. "Ndeshja e radhës në të cilën Interi do të luajë me stadiumin plot është në mesin e shkurtit. Në janar do të bëjmë një samit të sigurisë, që do të përfshijë klubet e Interit dhe Milanit. Qëllimi është izolimi i dhunuesve. Nuk mund të paguajmë të gjithë tifozët për sjelljet kriminale të disave", përfundon Renato Sakone, prefekti i Milanos.


MESFUSHORI KROAT

Modriç nuk rinovon me Realin, pritet të kalojë tek Interi

Luka Modriç ishte dëshira e Interit në merkaton e Liverës, por kroatit vendosi që të qëndronte në Spanjë. Te Reali ishin të bindur se kroatit do të rinovonte, megjithatë siç është edhe shprehja "ku ka zë nuk është pa gjë", edhe mesfushori duket se tundohej nga një aventurë italiane. Dje mediat spanjolle kanë lajmëruar se fituesi i "Topit të Artë" nuk preferon që të nënshkruajë një kontratë të re me kampionët e Europës. Modriç mund të kërkojë largimin nga Reali që në merkaton e janarit dhe Interi është të dera, duke pritur vetëm një fjalë nga nënkampioni i botës. Në Itali janë të bindur se 33-vjeçarin e pret një kontratë prej 10 milionë eurosh në sezon. Interi është gati që të shpenzojë pa fund vetëm që të çojë në "San Siro" lojtarin e vitit.



### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

1. Ishite dekret i sultanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.
38. Sateliti i Jupiterit.

39. Fillojnë matjet.
  41. Në krye tëv idealisatëve.
  42. Një Ibrahim violinist.
  44. Ekstreme në sirtar.
  45. Kështu shtë lojtari i under 21.
  47. Eshhtë gjuajtia personale.
  49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
  50. Gëlonin nga gladiatorët.
- VERTIKAL**
1. Eli këngëtare.
  2. Pak ekologjike.
  3. Rastis në kufij.
  4. Janë temperaturat më të ulëta.
  5. Inicialet e Lendl.
  6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
  7. Campion regjisore.
  8. Gabim rrjete në tenis.
  11. Janë si cilësi.
  12. Ishite gjuha e romakëve.
  15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
  16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
  17. I vihet kalit.
  18. Rrapo i luftëtarëve.
  19. Aktet pa kufij.
  20. Mbyllet me dorezë.
  21. Eshhtë periudha e ftohtë.
  23. Në krye të komandës.
  24. Një artist si Tristan Tzara.
  28. Janë sportistët që bëjnë stili të lirë.
  31. Hapin pa kufij.
  32. Qethen me qen.
  35. Një mendim.
  36. Kusturica, regjisor.
  37. Parajsja e humbur.
  39. Një stacion i famshëm orbital.
  40. Pak aromatike.
  43. Pak interesante.
  46. Lirë në qendër.
  48. Nota e diapazonit.

### Fjalëkryqi (2)

**HORIZONTAL**


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

**HORIZONTAL**


33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.

**VERTIKAL**


1. Gjysma e lapsit.
2. Përfundojnë pingul
3. Shkruhen për filma.
5. Duhen realizuar.
6. Gabim pa kufij.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazil.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

### SUDOKU

4		9		5		8		7
3	1			8	7			4
			2					9
		1	6			9	8	3
		2				5		
8	6	7			9	1		
	7				3			
6			1	9			2	5
1		4		2		6		8

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	4	9	8	5	1	3	6	2
5	2	1	6	7	3	4	8	9
6	8	3	9	2	4	1	7	5
2	1	5	7	8	9	6	4	3
3	6	7	1	4	2	5	9	8
8	9	4	3	6	5	7	2	1
4	3	6	2	1	8	9	5	7
9	5	2	4	3	7	8	1	6
1	7	8	5	9	6	2	3	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Argëtim filozofik

- Vetëm një sekret mund të mbajë një grua. Sekretin e moshës së saj.
- Veshët besojnë më veshtrë se sytë.
- Gjithmonë kam dashur të bëhem dikush, por duhej të isha më specifik.
- 99% e dështimeve vijnë për shkak të njerëzve që kanë si zakon të justifikohen.
- Kënaqësia e kuriozitetit tonë është një nga burimet më të mëdha të lumturisë në jetë.
- Shpesh gjej se ku duhet të shkoj duke filluar për dikuj tjetër.

### KRIPTOSKEME

8	4	1	2	3	4	6	5	3	4	1	4
1	2	8	1	5	8	4	7	10	6	4	3
10	6	7		2	7		11	6	2	1	4
10	7		15	1	12	1	2	3	4		10
1		12	1	4	3	2	6	4	3		1
4	2	6	11	3	2	6	4	3		1	14
1	2	4	16	2	7	16	6		15	1	4
1	2	8	3	14							1
1	19	1		4		11	3	4	2	6	15C
8	1	5	4		18	6	2	1	4	3	2
5	16	1	10	6	4	3	4	6		3	18P
10	3		15	3	18	6			14	8	14

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

M	I	K	E		K	M		S		E		
E	K	A			R	O	M	A	K	E	T	
K		M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
		M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K		T		S		
E	K	U		A	N	E	T	A	R	E	T	
R	E	T	E		E	I	R	A	N	I		
I	T	R		B	L	A	K	E		L		
M	I	A		R	E	D		E	K	I		
E				M	E	T	A	L	E	I	S	
T	E	K	E			M		K	U	M	T	
		M	O	R	A	V	I	A		M	A	E

- Dhe mos merrni drogë, nuk mjafton për të gjithë.
- Shumë herë ne jemi të mirë, sepse nuk mund të jemi të këqij.
- Budallai që ecën, është me më shumë vlerë se dhjetë intelektualë që rrinë.

### Thënie të mençura

- Unë thjesht shkruaj dhe pastaj pres që dikush të kalojë dhe të ketë nevojë për atë që unë shkruaj.
- Mos hezitoni, shkoni përpara. Shpesh është më e lehtë të kërkosh falje sesa të kërkosh leje.
- Të filozofosh është vetëm një mënyrë për të justifikuar melankolinë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A	
D	I	A	N	A	H	H	A	S	T	I	K	
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S	
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E	
T	I	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	T
K	E	N	E	I	A	G	R	A	R			
P	A	U	L	I	N	R	R	T				
A	K	E	O	T	A	A	D	D	I	M		
R	U	M	U	N	E	K	I	T	E	R	A	
E	T	I	E	R	I	A	M	A	N			
T	E	I	G	O	R	D	I	A	N	E		
I	N	T	A	R	O	M	A		T	I	T	

FJALËKRYQI (1)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O			
R	K	U	P	A	D	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	E
S	T	A	N	I	U	M	E	T	A	P	E	I
D	I	K	A	S	T	E	R	E		R	U	E
K	E	N	T		N	G	O	P	J	E	V	
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E			
A	R		N	I	O	L	A	I	R			
M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	N	A	N				
T	T	E	R	R	E	N	T	E	I	N	E	

FJALËKRYQI (2)

